

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 802/2004 e 7 prillit 2004 në zbatim të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 133,30.04.2004 fq. 0001 - 0039

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 802/2004 e 7 prillit 2004 në zbatim të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Komisioni i Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen mbi Zonën Ekonomike Europiane,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr.nr. 139/2004 të 20 janarit 2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (Rregullorja e KE-së për Bashkimet) [1] dhe veçanërisht nenin 23 pika 1 të saj,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 4064/89 të 21 dhjetorit 1989 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve [2], ndryshuar së fundi sipas Rregullores (KE) nr.nr. 1310/97 [3], dhe veçanërisht nenit 23 të saj;

Pas këshillimit me Komitetin Këshillimor,

Duke pasur parasysh që:

(1) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr.nr. 4064/89 e 21 dhjetorit 1989 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve është rihartuar, me ndryshime thelbësore në dispozitat e ndryshme të asaj rregulloreje,

(2) Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 447/98 [4] e 1 marsit 1998 mbi njoftimet, afatet kohore dhe seancat e parashikuara në Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 4064/89 duhet të ndryshohet, me qëllim që të reflektohen ato ndryshime. Për qëllime qartësie ajo duhet të shfuqizohet nga një rregullore e re.

(3) Komisioni ka miratuar masa në lidhje me termat e referencës për nëpunësit dëgjimorë në procedura të caktuara të konkurrencës.

(4) Rregullorja (KE) nr. 139/2004 bazohet në parimin e njoftimit të detyrueshëm të përqendrimeve para se ato të hyjnë në fuqi. Nga njëra anë, një njoftim ka pasoja të rëndësishme ligjore që janë të favorshme për palët e përqendrimit të propozuar, ndërsa, nga ana tjetër, mospërbushja e detyrimit për të bërë njoftim i ngarkon palët me gjoba dhe mund të shkaktojë edhe mosavantazhe civile mbi to. Kështu, është e nevojshme në interes të sigurisë ligjore të përcaktohet saktësisht objekti dhe përmbajtja e informacionit që duhet të jepet në njoftim.

(5) U takon palëve që bëjnë njoftimin t'i bëjnë një deklaram të plotë dhe të ndershëm Komisionit për faktet dhe rrethanat që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi mbi përqendrimin e njoftuar.

(6) Rregullorja (KE) nr.nr. 139/200 lejon, gjithashtu, që ndërmarrjet e interesuara të kërkojnë, me deklaratë të arsyetuar, para njoftimit, që një përqendrim që përmbush kërkesat e asaj rregulloreje t'i referohet Komisionit nga një ose më shumë Shtete Anëtare, ose t'i referohet një ose disa Shteteve Anëtare nga Komisioni, sipas rastit. Është e rëndësishme t'i jepet Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse informacioni i plotë,

me qëllim që t'u mundësohet atyre vlerësimi, brenda një periudhe kohe të shkurtër, nëse do të bëhet referim apo jo. Për këtë qëllim, deklaratat e arsyetuar që kërkon referimin duhet të përmbajë informacione të caktuara të veçanta.

(7) Me qëllim që të thjeshtësohet dhe shpejtohet shqyrtimi i njoftimeve dhe i deklaratave të arsyetuara, është e dëshirueshme që të këshillohet përdorimi i formularëve.

(8) Meqenëse njoftimi vë në lëvizje afate kohore ligjore të caktuara në pajtim me Rregulloren (KE) nr. 139/2004, duhet të përcaktohen kushtet që rregullojnë këto afate kohore dhe momenti kur ato hyjnë në fuqi.

(9) Rregullat duhet të vendosen për qëllimet e sigurisë ligjore në llogaritjen e afateve të parashikuara në Rregulloren (KE) nr. 139/2004. Veçanërisht fillimi dhe fundi i afateve dhe rrethanave që pezullojnë ecjen e këtyre afateve duhet të përcaktohen, duke iu kushtuar vëmendjen e duhur kërkesave që rrjedhin nga afatet kohore ligjore tepër të ngjeshura për procedimet.

(10) Dispozitat në lidhje me procedurën e Komisionit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të garantojnë plotësisht të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtat e mbrojtjes. Për këto qëllime, Komisioni duhet të bëjë dallimin ndërmjet palëve që njoftojnë përqendrimin, palëve të tjera të përfshira në përqendrimin e propozuar, palëve të treta dhe palëve në lidhje me të cilat Komisioni synon të marrë një vendim duke caktuar një gjobë ose pagesa të kamatëvonesave.

(11) Komisioni duhet t'u japë palëve që bëjnë njoftimin dhe palëve të tjera të përfshira në përqendrimin e propozuar, nëse ato kërkojnë, mundësinë të diskutojnë para njoftimit mbi përqendrimin e synuar jozyrtarisht dhe me konfidencialitet rigoroz. Përveç kësaj, Komisioni, pas njoftimit, duhet të mbajë kontakte të ngushta me ato palë, në masën e nevojshme për të diskutuar me to mbi çdo problem praktik ose ligjor që ai zbulon gjatë shqyrtimit të parë të çështjes, me synim, nëse është e mundur, zgjidhjen e këtyre problemeve me marrëveshje të përbashkët.

(12) Në përputhje me parimin e respektimit të të drejtave të mbrojtjes, palëve njoftuese duhet t'u jepet mundësia të paraqesin komentet e tyre mbi të gjitha kundërshtimet që propozon Komisioni, për t'u marrë parasysh në vendimet e tij. Palët e tjera të përfshira në përqendrimin e propozuar duhet të informohen në lidhje me kundërshtimet e Komisionit dhe duhet t'u jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre.

(13) Palëve të treta që tregojnë një interes të mjaftueshëm duhet t'u jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre, nëse ato bëjnë një kërkesë me shkrim për këtë qëllim.

(14) Personat e ndryshëm të autorizuar që bëjnë komente duhet ta bëjnë këtë me shkrim, për interesat e tyre dhe interesat e administrimit të shëndoshë, pa cenuar të drejtën e tyre për të kërkuar një seancë zyrtare me gojë, sipas rastit, për të plotësuar procedurën shkresore. Megjithatë, në raste urgjente, Komisionit duhet t'i jepet mundësia të vazhdojë menjëherë me seancat zyrtare me gojë të palëve njoftuese, të palëve të tjera ose të palëve të treta.

(15) Është e nevojshme të caktohen të drejtat e personave që duhet të dëgjojnë, në ç'masë duhet t'u jepet e drejta për të këqyrur dosjen e Komisionit, dhe në cilat kushte ata mund të përfaqësohen ose asistohen.

(16) Kur lejon mbikëqyrjen e dosjes, Komisioni duhet të garantojë ruajtjen e sekreteve të biznesit dhe informacioneve konfidenciale. Komisioni duhet të jetë në gjendje t'u kërkojë ndërmarrjeve që kanë paraqitur dokumente ose deklaratime për të identifikuar informacionin konfidencial.

(17) Me qëllim që Komisionit t'i mundësohet kryerja e një vlerësimi të duhur të detyrimeve të ofruara nga palët njoftuese, duke synuar në realizimin e bashkimit e përqendrimin të përputhshëm me tregun e përbashkët, dhe për të siguruar këshillimin e duhur me palët e tjera të përfshira, me palët e treta dhe me autoritetet e Shteteve Anëtare sipas parashikimit në Rregulloren (KE) nr. nr. 139/2004, veçanërisht nenin 18 pikat 1 dhe 4, nenin 19 pikat 1, 2, 3

dhe 5 të saj, duhet të përcaktohet procedura dhe afatet kohore për paraqitjen e detyrimeve të përmendura në nenin 6 pika 2 dhe nenin 8 pika 2 të asaj rregulloreje.

(18) Është gjithashtu e nevojshme të përcaktohen rregullat e zbatueshme për afate kohore të caktuara nga Komisioni.

(19) Komiteti Këshillimor mbi Përqendrimet duhet të japë mendimin e tij mbi bazën e një projektvendimi paraprak. Ai, për një çështje, duhet të këshillohet para së gjithash pasi hetimi për atë çështje të jetë përfunduar. Ky këshillim, megjithatë, nuk e pengon Komisionin ta rihapë një hetim, nëse është e nevojshme.

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

KAPITULLI I OBJEKTI

Neni 1 **Objekti**

Kjo rregullore zbatohet për kontrollin e përqendrimeve të kryera në pajtim me Rregulloren (KE) nr.nr. 139/2004.

KAPITULLI II NJOFTIME DHE DEKLARATA TË TJERA

Neni 2 **Personat e autorizuar për të bërë njoftime**

1. Njoftimet paraqiten nga personat ose ndërmarrjet e përmendura në nenin 4 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004.
2. Nëse njoftimet janë nënshkruar nga përfaqësuesit e personave ose ndërmarrjeve, këta përfaqësues paraqesin prova të shkruara që janë të autorizuar për të vepruar.
3. Njoftimet e përbashkëta duhet të jenë paraqitur nga një përfaqësues i përbashkët që është i autorizuar të transmetojë dhe të marrë dokumente në emër të palëve njoftuese.

Neni 3 **Paraqitja e njoftimeve**

1. Njoftimet paraqiten në mënyrën e parashikuar nga Formulari CO, siç përcaktohet në Shtojcën I. Brenda kushteve të përcaktuara në Shtojcën II, njoftimet mund të paraqiten në Formularin e Shkurtër siç përcaktohet atje. Njoftimet e përbashkëta paraqiten në një formular të vetëm.
2. Një origjinal dhe 35 kopje të Formularit CO dhe dokumentet shtesë i paraqiten Komisionit. Njoftimet paraqiten në adresën e përmendur në nenin 23 pika 1 dhe në formatin e përcaktuar nga Komisioni.
3. Dokumentet shtesë janë në origjinal ose kopje të origjinaleve; në rastin e fundit palët njoftuese vërtetojnë që ato janë të vërteta dhe të plota.
4. Njoftimet janë në një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit. Për palët njoftuese, kjo gjuhë është edhe gjuha e procedimit, si dhe e çdo procedimi pasues në lidhje me të njëjtin përqendrim. Dokumentet shtesë paraqiten në

gjuhën e tyre origjinale. Nëse gjuha origjinale nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, i bashkëngjitet një përkthim në gjuhën e procedimit.

5. Nëse njoftimet bëhen në përputhje me nenin 57 të Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Europiane, ato paraqiten në një nga gjuhët zyrtare të Shteteve EFTA ose gjuhën e punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes së EFTA-s. Nëse gjuha e zgjedhur për njoftimet nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, palët njoftuese e plotësojnë në të njëjtën kohë dokumentacionin me një përkthim në një gjuhë zyrtare të Komunitetit. Gjuha që zgjidhet për përkthim përcakton gjuhën që përdoret nga Komisioni si gjuha e procedimit për palët njoftuese.

Neni 4

Informacioni dhe dokumentet që duhen paraqitur

1. Njoftimet përmbajnë informacionin, duke përfshirë dokumentet e kërkuar në formularët e zbatueshëm, të përcaktuar në anekse. Informacioni është i saktë dhe i plotë.
2. Komisioni mund të heqë dorë nga detyrimi për të dhënë një informacion të caktuar në njoftim, duke përfshirë dokumentet, ose nga çdo kërkesë tjetër e përcaktuar në Shtojcat I dhe II, ku Komisioni është i mendimit që përputhja me ato detyrime ose kërkesa nuk është e nevojshme për shqyrtimin e çështjes.
3. Komisioni u vërteton me shkrim, pa vonesë, palëve njoftuese ose përfaqësuesve të tyre marrjen e njoftimit dhe të përgjigjes së çdo shkrese të dërguar nga Komisioni në përputhje me nenin 5 pikat 2 dhe 3.

Neni 5

Data e hyrjes në fuqi të njoftimit

1. Në pajtim me paragrafët 2, 3 dhe 4, njoftimet hyjnë në fuqi në datën në të cilën ata merren nga Komisioni.
2. Nëse informacioni, duke përfshirë dokumentet, që gjendet në njoftim është i paplotë nga pikëpamja lëndore, Komisioni informon palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre me shkrim dhe pa vonesë. Në këto raste, njoftimi hyn në fuqi në datën në të cilën informacioni i plotë merret nga Komisioni.
3. Ndryshimet lëndore në faktet që gjenden në njoftim, që dalin pas njoftimit që palët dinë ose duhet të dinë, ose çdo informacion i ri që del pas njoftimit që palët e dinë ose duhet të dinë dhe që duhet të ishte njoftuar, nëse dihej në momentin e njoftimit, i komunikohet Komisionit pa vonesë. Në këto raste, nëse këto ndryshime lëndore ose informacion i ri mund të ketë një efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e përqendrimit, njoftimi mund të konsiderohet nga Komisioni i efektshëm në datën në të cilën merret informacioni përkatës nga Komisioni; Komisioni informon palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre për këtë me shkrim dhe pa vonesë.
4. Informacioni i pasaktë ose i gabuar konsiderohet të jetë informacion i paplotë.
5. Nëse Komisioni boton faktin e njoftimit në përputhje me nenin 4 pika 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai përcakton datën në të cilën është marrë njoftimi. Nëse, pas zbatimit të paragrafëve 2, 3 dhe 4 të këtij neni, data e efektshme e njoftimit është pas datës së përcaktuar në atë botim, Komisioni nxjerr një botim tjetër në të cilin cakton datën e mëvonshme.

Neni 6

Dispozita të veçanta në lidhje me deklaratat e arsyetuara, shtesat dhe certifikimet

1. Deklaratat e arsyetuara brenda kuptimit të nenit 4 pikat 4 dhe 5 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 përmban informacionin, duke përfshirë dokumentet e kërkuara, në përputhje me Shtojcën III të kësaj rregulloreje.

2. Neni 2, neni 3 pika 1 fjalia e tretë, neni 3 pika 2 deri në pikën 5, neni 4, neni 5 pikat 1 dhe 2, fjalia e parë, neni 5 pikat 3 dhe 4, neni 21 dhe neni 23 i kësaj rregulloreje zbaton *mutatis mutandis* deklaratat e arsyetuara brenda kuptimit të nenit 4 pikat 4 dhe 5 të Rregullores (KE) nr. 139/2004.

Neni 2, neni 3 pika 1, fjalia e tretë, neni 3 pika 2 deri në pikën 5, neni 4, neni 5 pika 1 deri në pikën 4, neni 21 dhe neni 23 i kësaj rregulloreje zbatojnë *mutatis mutandis* për shtesat e njoftimeve dhe certifikimeve brenda kuptimit të nenit 10 pika 5 të Rregullores (KE) nr. 139/2004.

KAPITULLI III KUFIJTË KOHORË

Neni 7

Fillimi i afateve kohore

Afatet kohore fillojnë në ditën e punës, sipas përcaktimit në nenit 24 të kësaj rregulloreje, pas ngjarjes së cilës i referohet dispozita përkatëse e Rregullores (KE) nr. 139/2004.

Neni 8

Përfundimi i afateve kohore

Një afat kohor i llogaritur në ditë pune përfundon në fund të ditës së fundit të punës. Një afat kohor i caktuar nga Komisioni në kuptimin e një date kalendarike përfundon në fund të asaj dite.

Neni 9

Pezullimi i afatit kohor

1. Afatet kohore të përmendura në nenin 9 pika 4, nenin 10 pikat 1 dhe 3 e Rregullores (KE) nr. 139/2004 pezullohen, nëse Komisioni duhet të marrë një vendim, në përputhje me nenin 11 pika 3 ose nenin 13 pika 4 të asaj rregulloreje për një nga shkaqet e mëposhtme:

(a) informacioni i kërkuar nga Komisioni, në përputhje me nenin 11 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 nga një prej palëve njoftuese ose një palë tjetër e përfshirë, sipas përcaktimit të nenit 11 të kësaj rregulloreje, nuk është dhënë ose nuk është dhënë i plotë brenda afatit kohor të caktuar nga Komisioni;

(b) informacioni që Komisioni ka kërkuar, në përputhje me nenin 11 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 nga një palë e tretë, sipas përcaktimit në nenin 11 të kësaj rregulloreje, nuk jepet ose nuk jepet i plotë brenda afatit kohor të caktuar nga Komisioni, për shkak të rrethanave për të cilat është përgjegjëse një prej palëve njoftuese ose një palë tjetër e përfshirë, sipas përcaktimit në nenin 11 të kësaj rregulloreje;

(c) një prej palëve njoftuese ose një palë tjetër e përfshirë, sipas përcaktimit në nenin 11 të kësaj rregulloreje, ka refuzuar t'i nënshtrohet një inspektimi që mendohet i nevojshëm nga Komisioni në bazë të nenit 13 pika 1 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 ose të bashkëpunojë për kryerjen e një inspektimi të tillë në përputhje me nenin 13 pika 2 të asaj rregulloreje;

(d) palët njoftuese nuk kanë informuar Komisionin për ndryshimet lëndore në faktet që ndodhen në njoftim, ose për ndonjë informacion të ri të llojit të referuar në nenin 5 pika 3 të kësaj rregulloreje.

2. Afatet kohore të përmendura në nenin 9 pika 4, nenin 10 pika 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 pezullohen, nëse Komisioni duhet të marrë një vendim në lidhje me nenin 11 pika 3 të asaj rregulloreje, pa proceduar fillimisht me kërkesë të thjeshtë për informacion, për shkak të rrethanave për të cilat është përgjegjëse një prej ndërmarrjeve të përfshira në përqendrim.

3. Afatet kohore të përmendura në nenin 9 pika 4, nenin 10 pikat 1 dhe 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 pezullohen:

- (a) në rastet e përmendura në pikat a dhe b të paragrafit 1 për periudhën ndërmjet përfundimit të afatit të caktuar në kërkesën e thjeshtë për informacion, dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë që kërkohet me vendim;
- (b) në rastet e përmendura në pikën c të paragrafit 1 për periudhën ndërmjet përpjekjes së pasuksesshme për të kryer inspektimin, dhe përfundimit të inspektimit të urdhëruar me vendim;
- (c) në rastet e përmendura në pikën d të paragrafit 1 për periudhën ndërmjet ndodhjes së ndryshimit në faktet e përmendura në të, dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë;
- (d) në rastet e përmendura në paragrafin 2 për periudhën ndërmjet përfundimit të afatit të caktuar në vendim, dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë të kërkuar me vendim.

4. Pezullimi i këtij afati fillon në ditën e punës pas datës në të cilën ka ndodhur ngjarja që ka shkaktuar pezullimin. Ai përfundon me mbarimin e ditës në të cilën është hequr shkaku i pezullimit. Nëse një ditë e tillë nuk është ditë pune, pezullimi i afatit kohor përfundon me përfundimin e ditës pasuese të punës.

Neni 10

Respektimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të përmendura në nenin 4 pika 4, nënparagrafi i katërt, neni 9 pika 4, neni 10 pikat 1 dhe 3, dhe neni 22 pika 3 i Rregullores (KE) nr. 139/2004 respektohen, nëse Komisioni ka marrë vendimin përkatës para përfundimit të afatit.

2. Afatet kohore të përmendura në nenin 4 pika 4, nënparagrafi i dytë, neni 4 pika 5, nënparagrafi i tretë, neni 9 pika 2, neni 22 pika 1, nënparagrafi i dytë dhe 22 pika 2, nënparagrafi i dytë, i Rregullores (KE) nr. 139/2004 respektohen nga Shteti Anëtar përkatës, nëse ai Shtet Anëtar para përfundimit të afatit informon Komisionin me shkrim ose bën apo i bashkohet një kërkesë me shkrim, sipas rastit.

3. Afatet kohore të përmendura në nenin 9 pika 6 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 përmbushen, nëse autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar përkatës informon ndërmarrjet e interesuara në mënyrën e parashikuar në atë dispozitë para përfundimit të afatit.

KAPITULLI IV

USHTRIMI I SË DREJTËS PËR T'U DËGJUAR; SEANCAT DËGJIMORE

Neni 11

Palët që duhet të dëgjohen

Për qëllimet e të drejtave për t'u dëgjuar, në përputhje me nenin 18 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, veçohen palët e mëposhtme:

(a) palët njoftuese, dmth, personat ose ndërmarrjet që paraqesin një njoftim në përputhje me nenin 4 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004;

(b) palët e përfshira, dmth, palët në përqendrimin e propozuar të ndryshme nga palët njoftuese, si shitësi dhe ndërmarrja që është objekti i përqendrimit;

(c) personat e tretë, dmth, personat fizikë ose juridikë, duke përfshirë klientët, furnitorët dhe konkurrentët, me kusht që ata të demonstrojnë interes të mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 18 pika 4, fjalia e dytë e Rregullores (KE) nr. 139/2004, që veçanërisht është rasti:

- për anëtarët e organeve administrative ose drejtuese të ndërmarrjeve përkatëse ose përfaqësuesit e njohur të punonjësve të tyre;

- për shoqatat e konsumatorëve, nëse përqendrimi i propozuar ka të bëjë me një produkt ose shërbime që përdoren nga konsumatorët përfundimtarë.

(d) palët, në lidhje me të cilat Komisioni synon të marrë një vendim, në përputhje me nenin 14 dhe 15 të Rregullores (KE) nr. 139/2004.

Neni 12

Vendimet mbi pezullimin e përqendrimeve

1. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim, në përputhje me nenin 7 pika 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, që ndikon negativisht mbi një ose disa palë, ai, në përputhje me nenin 18 pika 1 të asaj rregulloreje, informon palët njoftuese dhe palët e tjera të përfshira me shkrim për kundërshtimet e tij dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ato bëjnë të ditura mendimet e tyre me shkrim.

2. Nëse Komisioni, në përputhje me nenin 18 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ka marrë një vendim sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkohësisht pa u dhënë mundësi palëve njoftuese dhe palëve të tjera të përfshira për të shprehur mendimet e tyre, ai pa vonesë u dërgon atyre tekstin e vendimit të përkohshëm dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ato bëjnë të ditura mendimet e tyre me shkrim.

Sapo palët njoftuese dhe palët e tjera të interesuara kanë bërë të ditura mendimet e tyre, Komisioni merr një vendim përfundimtar që anulon, ndryshon ose vërteton vendimin e përkohshëm. Nëse ato nuk i bëjnë të ditura mendimet e tyre brenda afatit kohor, vendimi i përkohshëm i Komisionit bëhet përfundimtar me kalimin e atij afati.

Neni 13

Vendimet dhe përmbajtja e çështjes

1. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim në përputhje me nenin 6 pika 3 ose nenin 8 pika 2 deri në pikën 6 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai para këshillimit me Komitetin Këshillimor për Përqendrimet, dëgjon palët në përputhje me nenin 18 pikat 1 dhe 3 të asaj rregulloreje.

Neni 12 pika 2 i kësaj rregulloreje zbatohet *mutatis mutandis*, nëse, në zbatim të nenit 18 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, Komisioni ka marrë një vendim, në përputhje me nenin 8 pika 5 të asaj rregulloreje, në mënyrë të përkohshme.

2. Komisioni ua paraqet kundërshtimet e veta me shkrim palëve të njoftuara.

Komisioni, gjatë njoftimit të kundërshtimeve, duhet të vendosë një afat kohor, brenda të cilit palët njoftuese mund të informojnë Komisionin për komentet e tyre me shkrim.

Komisioni informon palët e tjera të përfshira me shkrim në lidhje me këto kundërshtime.

Komisioni cakton gjithashtu një afat kohor brenda të cilit ato palë të tjera të interesuara mund të informojnë Komisionin për komentet e tyre me shkrim.

Komisioni nuk është i detyruar të marrë parasysh komentet e marra pas skadimit të një afati kohor që ai ka caktuar.

3. Palët, të cilave u drejtohen vërejtjet e Komisionit ose të cilat janë njoftuar për këto vërejtje, brenda afatit kohor të caktuar, paraqesin me shkrim komentet e tyre mbi vërejtjet. Në komentet e tyre me shkrim, ato mund të caktojnë të gjitha faktet dhe çështjet që ato dinë që janë të rëndësishme për mbrojtjen e tyre, dhe bashkëngjisin çdo dokument të rëndësishëm si provë për faktet e caktuara. Ato mund të propozojnë që Komisioni të dëgjojë persona që mund të përforcojnë ato fakte. Ato paraqesin një origjinal dhe 10 kopje të komenteve të tyre tek Komisioni në adresën e Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën të Komisionit. Një kopje elektronike paraqitet gjithashtu në të njëjtën

adresë dhe në formatin e caktuar nga Komisioni. Komisioni u paraqet kopje të këtyre komenteve me shkrim, pa vonesë, autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare.

4. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim, në pajtim me nenin 14 ose nenin 15 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai, para këshillimit me Komitetin Këshillimor për Përqendrimet, dëgjon në përputhje me nenin 18 pikat 1 dhe 3 të asaj rregulloreje palët në lidhje me të cilat Komisioni synon të marrë një vendim të tillë.

Procedura e parashikuar në paragrafin 2, nënparagrafët e parë dhe të dytë, dhe paragrafi 3 zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 14 **Seancat dëgjimore**

1. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim, në vijim të nenit 6 pika 3 ose nenit 8 pika 2 deri në pikën 6 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai duhet t'u ofrojë palëve njoftuese që e kanë kërkuar këtë, në komentet e tyre me shkrim, mundësinë për të zhvilluar argumentet e tyre në një seancë dëgjimore zyrtare. Ai, gjithashtu në faza të tjera të procedimit, mund t'u ofrojë palëve njoftuese mundësinë për të shprehur mendimet e tyre gojarisht.

2. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim, në përputhje me nenin 6 pika 3 ose nenin 8 pika 2 deri në pikën 6 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai u ofron palëve të tjera të përfshira që e kanë kërkuar këtë në komentet e tyre me shkrim, mundësinë për të zhvilluar argumentet e tyre në një seancë dëgjimore zyrtare. Ai, gjithashtu në faza të tjera të procedimit, mund t'u ofrojë palëve të tjera të përfshira mundësinë për të shprehur mendimet e tyre gojarisht.

3. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim, në përputhje me nenin 6 pika 3 ose nenin 8 pikat 2 deri në pikën 6 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ai u ofron palëve për të cilat ai propozon të vërë një gjobë ose një pagesë detyruese periodike, mundësinë për të zhvilluar argumentet e tyre në një seancë dëgjimore zyrtare, nëse kjo është kërkuar në komentet e tyre me shkrim. Ai, gjithashtu në faza të tjera të procedimit, mund t'u ofrojë këtyre palëve mundësinë për të shprehur mendimet e tyre gojarisht.

Neni 15 **Zhvillimi i seancave dëgjimore zyrtare**

1. Seancat dëgjimore zyrtare duhet të drejtohen nga nëpunësi dëgjimor në pavarësi të plotë.

2. Komisioni fton personat që do të dëgjojnë në ndjekin seancën zyrtare në ato data që ai cakton.

3. Komisioni fton autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të marrin pjesë në seancat dëgjimore zyrtare.

4. Personat e ftuar të marrin pjesë, paraqiten personalisht ose përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre ligjorë ose nga përfaqësuesit e autorizuar nga kushtetutat e tyre, sipas rastit. Ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve mund të përfaqësohen gjithashtu nga një agjent i autorizuar rregullisht i emëruar nga personeli i tyre i përhershëm.

5. Personat e dëgjuar nga Komisioni mund të asistohen nga avokatët e tyre ose nga persona të tjerë të kualifikuar dhe të autorizuar rregullisht të pranuar nga nëpunësi dëgjimor.

6. Seancat dëgjimore zyrtare nuk janë me dyer të hapura. Secili person mund të dëgjojë veçmas ose në prani të personave të tjerë të ftuar për të marrë pjesë, duke patur parasysh interesat legjitime të ndërmarrjeve në mbrojtje të sekreteve të tyre të biznesit dhe informacionit tjetër konfidencial.

7. Nëpunësi dëgjimor mund të lejojë palët, brenda kuptimit të nenit 11, shërbimet e Komisionit dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, të bëjnë pyetje gjatë seancës dëgjimore zyrtare.

Nëpunësi dëgjimor mund të bëjë një mbledhje përgatitore me palët dhe shërbimet e Komisionit për të lehtësuar organizimin efikas të seancës dëgjimore zyrtare.

8. Deklarimet e bëra nga secili person i dëgjuar regjistrohen. Me kërkesë regjistrimi i seancës dëgjimore zyrtare u jepet personave që marrin pjesë në seancë. Merren parasysh interesat legjitime të ndërmarrjeve në mbrojtje të sekreteve të tyre të biznesit dhe informacionit tjetër konfidencial.

Neni 16

Dëgjimi i personave të tretë

1. Nëse personat e tretë bëjnë kërkesë me shkrim për t'u dëgjuar, në përputhje me nenin 18 pika 4, fjalia e dytë, e Rregullores (KE) nr. 139/2004, Komisioni i informon ata me shkrim për natyrën dhe objektin e procedurës, dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ata duhet të bëjnë të ditura mendimet e tyre.

2. Personat e tretë të përmendur në paragrafin 1 i bëjnë të ditura mendimet e tyre me shkrim brenda afatit kohor të caktuar. Komisioni, sipas rastit, mund t'u ofrojë këtyre palëve të treta që kanë bërë këtë kërkesë në komentet e tyre me shkrim, mundësinë për të marrë pjesë në seancën dëgjimore zyrtare. Ai mund t'u ofrojë këtyre palëve të treta, edhe në raste të tjera, mundësinë e shprehjes së mendimeve të tyre me shkrim.

3. Komisioni po kështu mund të ftojë çdo person tjetër fizik ose juridik për të shprehur mendimet e tij me shkrim dhe me gojë duke përfshirë një seancë dëgjimore zyrtare.

KAPITULLI V

E DREJTA E INFORMIMIT MBI DOSJEN DHE TRAJTIMI I INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Neni 17

E drejta e informimit mbi dosjen dhe përdorimi i dokumenteve

1. Nëse bëhet kërkesë, Komisioni lejon të drejtën për informim mbi dosjen për palët e treta, të cilave ai u ka drejtuar një deklaratë kundërshtimi, për qëllimet e mundësimit të tyre të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes. E drejta e informimit lejohet pas njoftimit të deklarimit të kundërshtimeve.

2. Komisioni, me kërkesë, u jep palëve të tjera të përfshira, që janë informuar në lidhje me kundërshtimet, të drejtën e informimit mbi dosjen në masën që është e nevojshme për qëllimet e përgatitjes së komenteve të tyre.

3. E drejta e informimit mbi dosjen nuk përfshin informacionin konfidencial ose dokumentet e brendshme të Komisionit ose të autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare. E drejta e informimit mbi dosjen po ashtu nuk përfshin korrespondencën ndërmjet Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare ose ndërmjet këtyre të fundit.

4. Dokumentet që përftohen nëpërmjet këqyrjes së dosjes, në pajtim me këtë nen, mund të përdoren vetëm për qëllimet e procedimit përkatës në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 139/2004.

Neni 18

Informacioni konfidencial

1. Informacioni, duke përfshirë dokumentet, nuk komunikohet apo jepet nga Komisioni në masën që ai përmban sekrete biznesi ose informacion tjetër konfidencial, deklarimi i të cilit nuk konsiderohet i nevojshëm nga Komisioni për qëllimet e procedurës.

2. Çdo person që shpreh mendimet ose komentet e tij në përputhje me nenin 12, nenin 13 dhe nenin 16 të kësaj rregulloreje, ose jep informacion në përputhje me nenin 11 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ose i paraqet më vonë informacion të mëtejshëm Komisionit në kuadrin e së njëjtës procedurë, identifikon qartë çdo material që ai e konsideron të jetë konfidencial, duke dhënë arsyet dhe paraqet një version të veçantë jokonfidencial në datën që caktohet nga Komisioni.

3. Pa cenuar paragrafin 2, Komisioni mund t'u kërkojë personave të përmendur në nenin 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve në të gjitha rastet kur ata japin ose kanë dhënë dokumente ose deklarime, në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 139/2004, për të identifikuar dokumentet ose pjesë të dokumenteve që ata i konsiderojnë që përmbajnë sekrete biznesi ose informacion tjetër konfidencial që u takojnë atyre, dhe të identifikojnë ndërmarrjet në lidhje me të cilat këto dokumente duhet të konsiderohen konfidenciale.

Komisioni mund t'u kërkojë gjithashtu personave që përmenden në nenin 3 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve të identifikojnë çdo pjesë të një deklarimi të kundërshtimeve, përmbledhjes së çështjes ose një vendimi të marrë nga Komisioni, që për mendimin e tyre përmban sekrete biznesi.

Nëse sekretet e biznesit dhe informacioni tjetër konfidencial identifikohen, personat, ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve japin arsyet dhe një version të veçantë jokonfidencial në datën e caktuar nga Komisioni.

KAPITULLI VI DETYRIMET E OFRUARA NGA NDËRMARRJET E INTERESUARA

Neni 19

Afatet kohore për paraqitjen e detyrimeve

1. Detyrimet e ofruara nga ndërmarrjet e interesuara, në lidhje me nenin 6 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, i paraqiten Komisionit brenda jo më shumë se 20 ditë pune nga data e marrjes së njoftimit.

2. Detyrimet e ofruara nga ndërmarrjet e interesuara, në përputhje me nenin 8 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, i paraqiten Komisionit brenda jo më shumë se 65 ditë pune nga data në të cilën ka nisur procedimi.

Nëse, në përputhje me nenin 10 pika 3, nënparagrafi i dytë, i Rregullores (KE) nr. 139/2004, periudha për marrjen e një vendimi në përputhje me nenin 8 pikat 1, 2 dhe 3 zgjatet, periudha prej 65 ditë pune për paraqitjen e detyrimeve automatikisht zgjatet me të njëjtin numër ditësh pune.

Në rrethana të veçanta, Komisioni mund të pranojë detyrimet e ofruara pas skadimit të afatit kohor për paraqitjen e tyre brenda kuptimit të këtij paragrafi, me kusht që procedura e parashikuar në nenin 19 pika 5 të Rregullores (KE) nr. 139/2004 të respektohet.

3. Nenet 7, 8 dhe 9 zbatohen *mutatis mutandis*.

Neni 20

Procedura për paraqitjen e detyrimeve

1. Një kopje origjinale dhe 10 kopje të detyrimeve të ofruara nga ndërmarrjet e interesuara, në përputhje me nenin 6 pika 2 ose nenin 8 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, i paraqiten Komisionit në adresën e Drejtorisë së

Përgjithshme për Konkurrencën. Një kopje elektronike paraqitet gjithashtu në të njëjtën adresë dhe në një format të përcaktuar nga Komisioni. Komisioni u paraqet kopje të këtyre detyrimeve pa vonesë autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare.

2. Gjatë ofrimit të detyrimeve, në përputhje me nenet 6 pika 2 ose nenit 8 pika 2 të Rregullores (KE) nr. 139/2004, ndërmarrjet e interesuara në të njëjtën kohë identifikojnë çdo informacion që ato e konsiderojnë konfidencial, duke dhënë arsyet, dhe japin një version të veçantë jokonfidencial.

KAPITULLI VII DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 21

Transmetimi i dokumenteve

1. Transmetimi i dokumenteve dhe ftesat nga Komisioni tek të adresuarit kryhen në një nga mënyrat e mëposhtme:

- (a) dorëzimi dorazi me faturë;
- (b) letër të porositur me vërtetim fature;
- (c) faks me një kërkesë për vërtetim fature;
- (d) teleks;
- (e) postë elektronike me një kërkesë për vërtetimin e faturës.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore, paragrafi 1 zbatohet edhe për transmetimin e dokumenteve nga palët njoftuese, nga palë të tjera të përfshira ose nga palë të treta tek Komisioni.

3. Nëse një dokument dërgohet me teleks, me faks ose postë elektronike, ai supozohet që është marrë nga i adresuari në ditën në të cilën është dërguar.

Neni 22

Caktimi i afateve

Në caktimin e afateve të parashikuara, në përputhje me nenin 12 pikapikat 1 dhe 2, neni 13 pika 2 dhe nenin 16 pika 1, Komisioni merr parasysh kohën që duhet për përgatitjen e deklarimeve dhe urgjencën e çështjes. Ai merr gjithashtu parasysh ditët e punës si dhe pushimet publike në vendin e marrjes së komunikimit të Komisionit.

Afatet kohore caktohen në kuptimin e një date të saktë kalendarike.

Neni 23

Marrja e dokumenteve nga Komisioni

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 5 pika 1 të kësaj rregulloreje, njoftimet i jepen Komisionit në adresën e Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën, siç botohet nga Komisioni në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

2. Informacioni shtesë i kërkuar, për të përfunduar njoftimet, duhet të vijë në Komision tek adresa e caktuar në paragrafin 1.

3. Komentet me shkrim mbi komunikimet e Komisionit, në përputhje me nenin 12 pikat 1 dhe 2, nenin 13 pika 2 dhe nenin 16 pika 1 të kësaj rregulloreje, duhet të mbërrijë në Komision në adresën e përmendur në paragrafin 1 para skadimit të afatit të caktuar në secilin rast.

Neni 24

Përcaktimi i ditëve të punës

Shprehja “ditë pune” në Rregulloren (KE) nr. 139/2004 dhe në këtë rregullore do të thotë të gjitha ditët e javës, të ndryshme nga të shtunat dhe të dielat dhe ditët e festave të Komisionit, siç botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian para fillimit të çdo viti.

Neni 25

Shfuqizimi dhe dispozitat kalimtare

1. Pa cenuar paragrafët 2 dhe 3, Rregullorja (KE) nr. 447/98 është shfuqizuar që nga 1 maji 2004. Referencat tek rregullorja e shfuqizuar interpretohen si referenca në këtë rregullore.
2. Rregullorja (KE) nr. 447/98 vazhdon të zbatohet për çdo përqendrim që futet në objektin e Rregullores (KEE) nr. 4064/89.
3. Për qëllimet e paragrafit 2, seksionet 1 deri 12 të Shtojcës së Rregullores (KE) nr. 447/98 zëvendësohen nga seksionet 1 deri 11 të Shtojcës I të kësaj rregulloreje. Në këto raste referencat në këto seksione tek “Rregullorja KE e Bashkimeve” dhe tek “Rregulloja e Zbatimit” kuptohen përkatësisht si referenca tek dispozitat përkatëse të Rregullores (KEE) nr. 4064/89 dhe Rregullores (KE) nr. 447/98.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 maj 2004.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Hartuar

Nënshkruar në Bruksel, 7 prill 2004.

Për Komisionin

Franz Fischler

Anëtar i Komisionit

(1) GZ L 24, 29.1.2004, fq. 1.

(2) GZ L 395, 30.12.1989, fq. 1.

(3) GZ L 180, 9.7.1997, fq. 1.

(4) GZ L 61, 2.3.1998, fq. 1. Rregullore e ndryshuar me Aktin e Aderimit të vitit 2003.

Formulari CO në lidhje me njoftimin e një përqendrimi në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 139/2004**1. Hyrje****1.1 Qëllimi i formularit**

Ky formular përcakton informacionin që duhet të paraqitet, duke njoftuar palët gjatë paraqitjes së një njoftimi për Komisionin European të një fuzioni, përfitimi ose përqendrimi tjetër. Sistemi i kontrollit të bashkimeve i Bashkimit European parashikohet në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 139/2004 (këtu e më poshtë referuar si “Rregullorja KE e Bashkimeve”) dhe në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. xx/2004 (këtu e më poshtë referuar si “Rregullore Zbatuese”), të cilës i bashkëngjitet ky Formular CO. [1] Teksti i këtyre rregullave, si dhe dokumente të tjerë përkatës mund të gjenden në pjesën e konkurrencës tek faqja “Europa” e Komisionit.

Me qëllim që të kufizohet koha dhe shpenzimet e përfshira në respektimin e procedurave të ndryshme në vende të ndryshme në veçanti, Bashkimi European ka ngritur një sistem të kontrollit të bashkimeve, nëpërmjet të cilit përqendrimet që janë një dimension Komunitar (normalisht, nëse palët në përqendrim kalojnë pragje të caktuara xhiroje) [2] vlerësohen nga Komisioni European në një procedurë të vetme (parimi “one stop shop”). Bashkimet që nuk kalojnë pragjet e xhiros mund të futen në kompetencën e autoriteteve të Shteteve Anëtare përgjegjës për kontrollin e Bashkimit.

Rregullorja KE e Bashkimeve kërkon që Komisioni të marrë vendim brenda një afati ligjor. Në një fazë fillestare Komisioni normalisht ka 25 ditë pune për të vendosur nëse duhet të lejohet përqendrimin ose të “fillojë procedimin”, dmth, të ndërmarrë një hetim të thellë [3]. Nëse Komisioni vendos të fillojë një procedim, ai normalisht duhet të marrë një vendim përfundimtar brenda jo më shumë se 90 ditë pune nga data kur fillon procedimi [4].

Duke ditur këto afate dhe që parimi “one stop shop” të japë rezultate, është thelbësore që Komisionit t’i jepet në kohë informacioni i kërkuar për të kryer hetimin e nevojshëm dhe për të vlerësuar ndikimin e përqendrimit në tregjet përkatës. Kjo kërkon që në momentin e njoftimit të jepet një sasi e caktuar informacioni.

Pranohet që informacioni i kërkuar në këtë formular është thelbësor. Megjithatë, eksperiencia ka treguar që, në varësi të karakteristikave të veçanta të çështjes, nuk është i nevojshëm gjithmonë i gjithë informacioni për një shqyrtim të përshtatshëm të përqendrimit të propozuar. Për pasojë, nëse ju jeni i mendimit që një informacion i caktuar që kërkohet në këtë formular mund të mos jetë i nevojshëm për shqyrtimin nga ana e Komisionit të çështjes, ju jeni i inkurajuar t’i kërkonti Komisionit të heqë dorë nga detyrimi për të dhënë informacion të caktuar (“heqje dorë nga përgjegjësia”), për më shumë hollësi shih Seksionin 1.3(g). Kontaktet e paranjoftimit janë tepër të vlefshme për të dy palët njoftuese dhe Komisionin, në caktimin e masës së saktë të informacionit që kërkohet në një njoftim, dhe në pjesën më të madhe të çështjeve, do të rezultojë në një pakësim të konsiderueshëm të informacionit të kërkuar. Palët njoftuese mund t’u referohen praktikave më të mira të Komisionit mbi zhvillimin e procedimeve të BE-së për Kontrollin e bashkimeve, që përmban udhëzime për kontaktet e paranjoftimit dhe përgatitjen e njoftimeve.

Përveç kësaj, duhet të vihet në dukje që përqendrimet të caktuara, që mund të demonstrojnë shqetësime konkurrence, mund të njoftohen duke përdorur një formular të shkurtër që i është bashkëngjitur Rregullore Zbatuese, si Shtojca II.

1.2. Kush duhet të njoftojë

Në rastin e një bashkimi, në kuptimin e nenit 3 pika 1 gërma a të Rregullore së KE-së për Bashkimet ose përfitimit të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrjeje brenda kuptimit të nenit 3 pika 1 gërma b të Rregullore së KE-së për

Bashkimet, njoftimi bëhet së bashku nga palët në bashkim ose nga ato që përftojnë kontroll të përbashkët sipas rastit [5].

Në rastin e përftimit të një zotërimi kontrolli në një ndërmarrje nga një tjetër, njoftimin duhet ta bëjë përftuesi.

Në rastin e një oferte publike për të përftuar një ndërmarrje, njoftimin duhet ta bëjë ofertuesi.

Secila palë që bën njoftimin është përgjegjëse për saktësinë e informacionit që ajo jep.

1.3. Kërkesa për një njoftim të saktë dhe të plotë

I gjithë informacioni i kërkuar nga ky formular duhet të jetë i saktë dhe i plotë. Informacioni i kërkuar duhet të jepet në seksionin e duhur të këtij formulari.

Veçanërisht duhet të vini re që:

(a) Në përputhje me nenin 10 pika 1 të Rregullores së KE-së për Bashkimet dhe nenin 5 pikat 2 dhe 4 të Rregullores Zbatuese, afatet kohore të Rregullores së KE-së për Bashkimet në lidhje me njoftimin hyjnë në fuqi pasi i gjithë informacioni që duhet të paraqitet së bashku me njoftimin të jetë marrë nga Komisioni. Kjo kërkesë duhet të sigurojë që Komisioni të jetë në gjendje të vlerësojë bashkimin e njoftuar brenda afateve kohore rigoroze të parashikuara nga Rregullorja e KE-së për Bashkimet.

(b) Palët njoftuese duhet të verifikojnë, në kuadrin e përgatitjes së njoftimit të tyre, që emrat dhe numrat e kontaktit dhe veçanërisht numrat e faksit dhe adresat e postës elektronike që i jepen Komisionit të jenë të saktë, funksionale dhe të përditësuar.

(c) Informacioni i pasaktë ose i gabuar në njoftim konsiderohet të jetë informacion i paplotë (neni 5 pika 4 i Rregullores Zbatuese).

(d) Nëse një njoftim është i paplotë, Komisioni informon palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre me shkrim dhe pa vonesë. Njoftimi hyn në fuqi në datën në të cilën informacioni i plotë dhe i saktë merret nga Komisioni (neni 10 pika 1 i Rregullores së KE-së për Bashkimet, nenin 5 pikat 2 dhe 4 i Rregullores Zbatuese).

(e) Në bazë të nenit 14 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për bashkimet, palët njoftuese që, me qëllim ose neglizhencë, japin informacion të pasaktë ose të gabuar, mund të ngarkohen me gjobë deri në 1% të xhiros së plotë të ndërmarrjes përkatëse. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 6 paragrafi 3 pika 3 gërma a dhe nenin 8 pika 6 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet, Komisioni mund të shfuqizojë vendimin e tij për përputhshmërinë e një bashkimi të njoftuar, nëse ai është bazuar në informacion të pasaktë për të cilin mban përgjegjësi një nga ndërmarrjet.

(f) Ju mund të kërkonte me shkrim që Komisioni të pranojë që njoftimi është i plotë pavarësisht mosdhënies së informacionit të kërkuar nga ky formular, nëse ky informacion nuk u jepet në mënyrë të arsyeshme pjesërisht ose plotësisht (për shembull, për shkak të mosdhënies së informacionit mbi shoqërinë e synuar gjatë një oferte të kundërshtuar).

Komisioni e shqyrton këtë kërkesë, me kusht që ju të jepni arsyet për mosdhënien e atij informacioni dhe të jepni vlerësimet tuaja më të mira për të dhënat që mungojnë, së bashku me burimet e vlerësimeve. Nëse është e mundur, duhet të jepen edhe tregues se ku mund të merret një informacion i kërkuar që nuk është dhënë prej jush nga Komisioni.

(g) Ju mund të kërkonte me shkrim që Komisioni të pranojë që njoftimi është i plotë, pavarësisht mosdhënies së informacionit të kërkuar nga ky formular, nëse ju jeni i mendimit që çdo informacion i veçantë i kërkuar, në versionin e shkurtuar ose të plotë, mund të mos jetë i nevojshëm për shqyrtimin e çështjes nga Komisioni.

Komisioni e shqyrton këtë kërkesë, me kusht që ju të jepni arsye të përshtatshme pse informacioni nuk është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për hetimin e tij në veprimin e njoftuar. Ju duhet të shpjegoni këtë gjatë kontakteve tuaja para njoftimit me Komisionin, dhe të paraqisni një kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga përgjegjësia, duke i kërkuar Komisionit t'ju lirojë nga detyrimi për të dhënë atë informacion, në përputhje me nenin 4 pika 2 të Rregullores Zbatuese.

1.4. Si bëhet njoftimi

Njoftimi duhet të bëhet në një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit Europian. Kjo gjuhë pas kësaj do të jetë gjuha e procedimit për të gjitha palët njoftuese. Nëse njoftimet janë bërë në përputhje me nenin 12 të Protokollit 24 të Marrëveshjes së EEA-s në një gjuhë zyrtare të një shteti të EFTA-s, që nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit. Njoftimi duhet të plotësohet njëkohësisht me një përkthim në një gjuhë zyrtare të Komunitetit.

Informacioni i kërkuar nga ky formular duhet të vendoset duke përdorur seksionet dhe numrat e paragrafëve të formularit, duke nënshkruar një deklaratë sipas parashikimit në seksionin 11, dhe duke bashkëngjitur dokumentacionin mbështetës. Për mbushjen e seksioneve 7 deri 9 të këtij formulari, palët njoftuese ftohen të shqyrtojnë nëse, për qëllime qartësie, këto seksione paraqiten më mirë në rend numerik, apo ato mund të grupohen së bashku për secilin treg të veçanti që preket (ose grup i tregjeve të prekura).

Për qëllime qartësie, një pjesë e informacionit duhet të futen në anekse. Megjithatë, është thelbësore që të gjithë pjesët kryesore të informacionit dhe veçanërisht informacioni për pjesën e tregut për palët dhe konkurrentët e tyre të paraqiten në strukturën e Formularit CO. Shtojcat e këtij formulari përdoren vetëm për plotësimin e informacionit që jepet në formular.

Të dhënat për hollësitë duhet të jepen në një format që jepet nga Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën e Komisionit (DP Konkurrencës). Për një proces hetimi të rregullt, është thelbësore që hollësitë e kontaktit të jenë të sakta. Disa raste të hollësive të pasakta të kontaktit mund të jetë shkak për deklarimin e një njoftimi të paplotë.

Dokumentet mbështetëse paraqiten në gjuhën e tyre origjinale. Nëse kjo nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, ato duhet të përkthehen në gjuhën e procedimit (neni 3 pika 4 i Rregullores Zbatuese).

Dokumentet shoqëruese mund të jenë në origjinal ose kopje të origjinaleve. Në rastin e fundit, pala njoftuese duhet të vërtetojë që ato janë të vërteta dhe të plota.

Një origjinal dhe 35 kopje të Formularit CO dhe të dokumenteve shoqëruese i paraqiten Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën të Komisionit.

Njoftimi paraqitet në adresën e përmendur në nenin 23 pika 1 të Rregullores Zbatuese dhe në formatin e përcaktuar nga Komisioni herë pas here. Kjo adresë botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Njoftimi dihet t'i jepet Komisionit në ditët e punës sipas përcaktimit në nenin 24 të Rregullores Zbatuese. Me qëllim që të mundësohet prej tij regjistrimi në të njëjtën ditë, ai duhet të paraqitet para orës 17.00 nga e hëna deri të enjten, dhe para orës 16.00 të premtëve dhe ditëve të punës para ditëve të festave dhe ditëve të festave të tjera që përcaktohen nga Komisioni dhe botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Udhëzimet për sigurinë, të dhëna në faqet e internetit të DP të Konkurrencës, duhet të respektohen.

1.5. Konfidencialiteti

Neni 287 i Traktatit dhe neni 17 pika 2 i Rregullores së KE-së për Bashkimet si dhe dispozitat përkatëse të Marrëveshjes ZEE [6] kërkojnë që Komisioni, Shtetet Anëtare, Autoriteti i Mbikëqyrjes EFTA dhe shtetet EFTA, nëpunësit e tyre dhe punonjës të tjerë të mos deklarojnë informacionin që ata kanë përfutur nëpërmjet zbatimit të Rregullores së llojit që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional. I njëjti parim duhet të zbatohet edhe për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet palëve njoftuese.

Nëse ju besoni që interesat tuaja do të dëmtohen, nëse një nga informacionet që u kërkohet do të botohej ose do t'u bëhej i ditur palëve të tjera, këtë informacion paraqiteni veçmas, ku në secilën faqe të jetë shënuar qartë "Sekrete Biznesi". Ju duhet të jepni edhe arsyet pse ky informacion nuk duhet të deklarohet ose botohet.

Në rastin e bashkimeve ose përfitimeve të përbashkëta, ose në raste të tjera ku njoftimi bëhet nga më shumë se njëra prej palëve, sekretet tregtare mund të paraqiten nën një titull tjetër dhe të bëhet referencë në njoftim si shtojcë. Të gjitha këto shtojca duhet të përfshihet në deklaratë me qëllim që njoftimi të konsiderohet i plotë.

1.6 Përkufizimet dhe udhëzimet për qëllimet e këtij formulari

Pala ose palët njoftuese: në rastet ku një njoftim paraqitet nga vetëm një prej ndërmarrjeve që është palë në një veprim, “palët njoftuese” përdoret si referencë vetëm tek njëra ndërmarrje që faktikisht paraqet njoftimin.

Pala(ët) në bashkim ose palët: këto terma kanë të bëjnë me palët përfutuese dhe palët e përfutura, ose me palët që bashkohen, duke përfshirë të gjitha ndërmarrjet në të cilat përftohet një zotërim kontrolli ose që i nënshtrohet një oferte publike.

Nëse nuk është përcaktuar ndryshe, termat pala(ët) njoftuese dhe pala(ët) në bashkim përfshijnë të gjitha ndërmarrjet që u takojnë grupeve të njëjtëve si dhe ato palë.

Tregjet e prekur: Seksioni 6 i këtij formulari kërkon që palët njoftuese të identifikojnë tregjet e produkteve përkatëse dhe më tej të identifikojnë se cili nga këta tregje përkatës mund të preken nga veprimi i njoftuar. Ky përcaktim i tregjeve të prekur përdoret si bazë për marrjen e informacionit për një numër çështjesh të tjera që gjenden në këtë formular. Përcaktimet e dhëna nga palët njoftuese referohen në këtë formular si treg(je) të prekura. Ky term i referohet një tregu përkatës që përbëhet nga produkte ose shërbime.

Viti: të gjitha referencat në fjalën vit në këtë formular duhet të kuptohen si kuptimi i vitit kalendarik, përveç kur deklarohet ndryshe. I gjithë informacioni i kërkuar në këtë formular, nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet të lidhet me vitin para atij të njoftimit.

Të dhënat financiare të kërkuara në seksionet 3.3 deri 3.5 duhet të jepen në euro me kurset mesatare të këmbimit që mbizotërojnë për vitet ose periudhat e tjera në fjalë.

Të gjitha referencat që gjenden në këtë formular janë për nenet dhe paragrafët e Rregullores së KE-së për Bashkimet, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

1.7. Dhënia e informacionit punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre

Komisioni do të donte të tërhiqte vëmendjen për detyrimet që palët në një bashkim kanë në bazë të rregullave Komunitare dhe/ose të brendshme mbi informacionin dhe këshillimin, në lidhje me veprimet e një natyre të koncentruar kundrejt punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre.

SEKSIONI 1

Përshkrimi dhe bashkimi

1.1 Jepni një përmbledhje të shkurtër të përqendrimit, që përcakton palët në bashkim, natyrën e bashkimit (për shembull, bashkimi, përfitim ose ndërmarrje e përbashkët), sferat e aktivitetit të palëve njoftuese, tregjet në të cilat bashkimi do të ketë ndikim (duke përfshirë tregjet e ndikuara [7]), dhe arsyetimin strategjik dhe ekonomik të bashkimit.

1.2 Jepni një përmbledhje (deri në 500 fjalë) të informacionit të dhënë në seksionin 1.1. Synohet që kjo përmbledhje të botohet në adresën e internetit të Komisionit në datën e njoftimit. Përmbledhja duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të mos përmbajë informacion konfidencial ose sekrete biznesi.

SEKSIONI 2

Informacioni për palët

2.1 Informacion për palën (ose palët) njoftuese

Jepni hollësi për:

2.1.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

2.1.2 natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

2.1.3 emrin, adresën dhe numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike dhe pozicionin që ushtrohet nga personi i përshtatshëm i kontaktit; dhe

2.1.4. një adresë postare shërbimi për palët njoftuese (ose secilën prej palëve njoftuese) tek të cilat mund të dorëzohen dokumentet, dhe veçanërisht vendimet e Komisionit. Duhet të jepet emri, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike të një personi në këtë adresë që është i autorizuar të pranojë postën.

2.2. Informacioni mbi palët e tjera [8] në përqendrim

Për secilën palë në bashkim (përveç palës ose palëve njoftuese) jepni hollësi për:

2.2.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

2.2.2. natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

2.1.3 emrin, adresën dhe numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike dhe pozicionin që ushtrohet nga personi i përshtatshëm i kontaktit; dhe

2.1.4. një adresë postare shërbimi për palët (ose secilën prej palëve) tek të cilat mund të dorëzohen dokumentet, dhe veçanërisht vendimet e Komisionit. Duhet të jepet emri, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike të një personi në këtë adresë që është i autorizuar të pranojë postën.

2.3. Caktimi i përfaqësuesve

Nëse njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin prova shkresore që ata janë të autorizuar për të vepruar. Prova me shkrim duhet të përmbajë emrin dhe pozicionin e personave që japin këtë autorizim.

Jepni të dhënat e mëposhtme të kontaktit për çdo përfaqësues që është autorizuar të veprojë për një prej palëve në bashkim, duke treguar kë ata përfaqësojnë:

2.3.1. emrin e përfaqësuesit

2.3.2. adresën e përfaqësuesit

2.3.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të personit që duhet të kontaktohet dhe

2.3.4. një adresë të përfaqësuesit (në Bruksel nëse ka) ku mund të dërgohet korrespondenca dhe të dorëzohen dokumentet.

SEKSIONI 3

Hollësi për përqendrimin

3.1. Përshkruani natyrën e bashkimit që njoftohet. Për ta bërë këtë, deklaroni:

- (a) nëse bashkimi i propozuar është një bashkim i plotë ligjor, një përfitim i kontrollit të vetëm ose të përbashkët, një ndërmarrje e përbashkët me funksion të plotë brenda kuptimit të nenit 3 pika 4 të Rregullores së KE-së për bashkimet, ose një kontratë ose mjet tjetër që jep kontroll të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë brenda kuptimit të nenit 3 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet;
- (b) nëse bashkimit të palëve u nënshtrohet një pjesë apo tërësia e palëve;
- (c) një shpjegim të shkurtër të strukturës ekonomike dhe financiare të bashkimit;
- (d) nëse ndonjë ofertë publike për letrat me vlerë të një pale nga një palë tjetër ka mbështetjen e bordeve mbikëqyrëse të palës së parë të menaxhimit ose organeve të tjera që përfaqësojnë ligjërisht palën;
- (e) data e propozuar ose e pritur për çdo ngjarje të rëndësishme që është planifikuar për të përfunduar bashkimin;
- (f) struktura e propozuar e pronësisë dhe kontrolli pas përfundimit të bashkimit;
- (g) çdo mbështetje financiare ose të lloji tjetër që merret nga një burim i caktuar (duke përfshirë autoritetet publike) nga njëra prej palëve, natyrën dhe shumën e kësaj mbështetjeje; dhe
- (h) sektorët ekonomikë të përfshirë në bashkim.

3.2. Tregoni vlerën e bashkimit (çmimin e blerjes ose vlerën e të gjithë sendeve pasurore të përfshirë, sipas rastit).

3.3. Për secilën prej ndërmarrjeve të prekura nga bashkimi [9] jepni të dhënat e mëposhtme [10] për vitin e fundit financiar:

3.3.1. xhiron botërore;

3.3.2. xhiron Komunitare;

3.3.3. xhiron brenda EFTA-s;

3.3.4. xhiron në secilin Shtet Anëtar;

3.3.5. xhiron në çdo shtet të EFTA-s;

3.3.6. Shtetin Anëtar, nëse ka, në të cilin kryhet më shumë se dy të tretat e xhiros Komunitare; dhe

3.3.7. shtetin e EFTA-s, nëse ka, ku kryhet më shumë se dy të tretat e xhiros së EFTA-s

3.4 Për qëllimet e nenit 1 pika 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, nëse veprimi nuk i arrin pragjet që caktohen në nenin 1 pika 2, jepni të dhënat e mëposhtme për vitin e fundit financiar.

3.4.1. Shtetet Anëtare, nëse ka, ku xhironja e plotë e kombinuar për të gjitha ndërmarrjet e interesuara është më shumë se 100 milion Euro; dhe

3.4.2. Shtetet Anëtare, nëse ka, ku xhironja e plotë e secilës prej të paktën dy prej ndërmarrjeve të interesuara është më shumë se 25 milion Euro.

3.5. Për qëllimet e përcaktimit nëse bashkimi kualifikohet si një çështje bashkëpunimi me EFTA-n [11], jepni informacionin e mëposhtëm në lidhje me vitin e fundit financiar.

3.5.1. është xhironja e kombinuar e ndërmarrjeve të interesuara në territorin e shteteve EFTA-s e barabartë ose më e madhe se 25% e xhiros së tyre të plotë në territorin e EEA-së?

3.5.2. a ka secila ose të paktën dy ndërmarrje të interesuara një xhiro që i kalon 250 milion Euro në territorin e shteteve të EFTA-s?

3.6 Përshkruani arsyet ekonomike të bashkimit.

SEKSIONI 4

Pronësia dhe kontrolli [12]

4.1 Për secilën prej palëve në bashkim jepni një listë të të gjitha ndërmarrjeve që i takojnë të njëjtit grup.

Kjo listë duhet të përfshijë:

4.1.1. të gjitha ndërmarrjet ose personat që kontrollojnë këto palë, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt;

4.1.2. të gjitha ndërmarrjet aktive në një treg të prekur [13] që kontrollohet, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt:

(a) nga këto palë;

(b) nga një ndërmarrje tjetër e identifikuar në 4.1.1.

Për çdo hyrje të renditur më sipër, duhet të saktësohet natyra dhe mjetet e kontrollit.

Informacioni i kërkuar në këtë seksion mund të ilustrohet nga përdorimi i organigramave ose diagrameve për të treguar strukturën dhe kontrollin e ndërmarrjeve

4.2. Në lidhje me palët në bashkim dhe çdo ndërmarrje ose person të identifikuar në përgjigje të seksionit 4.1, jepni:

4.2.1. një listë të të gjitha ndërmarrjeve të tjera që janë aktive në tregjet e prekura (tregjet e prekura janë përcaktuar në seksionin 6) në të cilët ndërmarrjet ose personat e grupit kanë individualisht ose bashkërisht 10% ose më shumë të të drejtave të votës, kapitalit aksionar të dhënë ose letra të tjera me vlerë në secilin rast, identifikoni zotëruesin dhe deklaroni përqindjen e zotëruar;

4.2.2. një listë për secilën ndërmarrje të anëtarëve të bordeve të tyre të menaxhimit, që janë gjithashtu edhe anëtarë të bordeve të menaxhimit ose të bordeve të mbikëqyrjes të një ndërmarrjeje tjetër që është aktive në tregjet e prekura; dhe (sipas rastit) për secilën ndërmarrje një listë të anëtarëve të bordeve të tyre të mbikëqyrjes që janë gjithashtu anëtarë të bordeve të menaxhimit të një ndërmarrjeje tjetër që është aktive në tregjet e prekura. Në secilin rast, identifikoni emrin e ndërmarrjes tjetër dhe pozicionet e mbajtura;

4.2.3. hollësi mbi përfitimet e bëra gjatë tre viteve të fundit nga grupet e identifikuara më sipër (seksioni 4.1) të ndërmarrjeve aktive në tregjet e prekura sipas përcaktimit në seksionin 6.

Informacioni i dhënë këtu duhet të ilustrohet me organigrama ose diagrama për të mundësuar një kuptim më të mirë.

SEKSIONI 5

Dokumentacioni shoqëruar

Palët njoftuese duhet të paraqesin sa më poshtë:

5.1. kopje të versioneve përfundimtare ose të fundit të të gjithë dokumenteve që realizojnë përqendrimin, qoftë si marrëveshje ndërmjet palëve në përqendrim, përfitim të një zotërimi kontrollues ose ofertë publike;

5.2 në një ofertë publike, një kopje të dokumentit të ofertës; nëse nuk mund të jepet në momentin e njoftimit, ai duhet të paraqitet menjëherë sapo të jetë e mundur dhe jo më vonë se sa kur u dërgohet aksionarëve;

5.3. kopje të raporteve dhe llogarive vjetore të fundit për të gjitha palët në përqendrim; dhe

5.4. kopje të të gjitha analizave, raporteve, studimeve, vëzhgimeve dhe çdo dokument i krahasueshëm, që përgatitet nga ose për një anëtar(ë) të bordit të drejtorëve, ose bordin mbikëqyrës, ose person (a) të tjerë që ushtrojnë funksione të ngjashme (ose të cilëve këto funksione u janë deleguar ose caktuar), ose mbledhjes së aksionarëve, për qëllimet e vlerësimit ose analizimit të përqendrimit në lidhje me pjesët në treg, kushtet konkurruese, konkurrentët (faktikë ose potencialë), arsyet e përqendrimit, mundësinë për rritjen e shitjeve ose zgjerimin në produkte ose tregje të tjerë gjeografikë, dhe/ose kushte të përgjithshme në treg. [14]

Për secilin prej këtyre dokumenteve, tregoni (nëse nuk është në vetë dokumentin) datën e përgatitjes, emrin dhe titullin e secilit individ që ka përgatitur secilin prej këtyre dokumenteve.

SEKSIONI 6

Përkufizimet e tregut

Produkti përkatës dhe tregjet gjeografike përcaktojnë objektin brenda të cilit duhet të vlerësohet fuqia e tregut e subjektit të ri që rrjedh nga përqendrimi. [15]

Pala ose palët njoftuese duhet të japin të dhënat që kërkohen duke patur parasysh përkufizimet e mëposhtme:

I. Tregjet përkatës të produkteve

Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha ato produkte dhe/ose shërbime që konsiderohen si të shkëmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për shkak të karakteristikave të produkteve, çmimeve të tyre dhe përdorimit që duhet. Një treg përkatës i produktit në disa raste mund të përbëhet nga një numër produktesh individuale dhe/ose shërbimesh që paraqesin në një masë të madhe karakteristika fizike dhe teknike të njëjta dhe janë të shkëmbyeshme.

Faktorët në lidhje me vlerësimin e tregut përkatës të produktit përfshin analizën pse përfshihen produktet ose shërbimet në këto tregje dhe pse të tjerët përjashtohen duke përdorur përkufizimin e mësipërm dhe duke marrë parasysh, për shembull, zëvendësueshmërinë, kushtet e konkurrencës, çmimet, elasticitetin e çmimeve dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për përkufizimin e tregjeve të produkteve (për shembull, zëvendësueshmërinë e anës së furnizimit në rastet e përshtatshme).

II. Tregjet përkatës gjeografikë

Tregu përkatës gjeografik përbëhet nga zona në të cilën angazhohen ndërmarrjet e interesuara për furnizimin dhe kërkesën e produkteve ose shërbimeve përkatëse, në të cilin kushtet e konkurrencës janë homogjene në masë të mjaftueshme, dhe që mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje, veçanërisht për shkak se kushtet e konkurrencës janë qartësisht të ndryshme në ato zona.

Faktorët që kanë të bëjnë me tregun përkatës gjeografik përfshijnë ndër të tjera natyrën dhe karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve përkatëse, ekzistencën e barrierave të hyrjes, preferencat e konsumatorëve, diferencat e dukshme në pjesët e tregut të ndërmarrjeve ndërmjet zonave gjeografike ose diferenca të mëdha në çmime.

III. Tregjet e prekura

Për qëllimet e informacionit të kërkuar në këtë formular, tregjet e prekura përbëhen nga tregjet përkatëse të produktit ku, në territorin e ZEE-së, në Komunitet, në territorin e shteteve të EFTA-s, në çdo Shtet Anëtar ose në çdo shtet të EFTA-s:

(a) dy ose më shumë prej palëve në përqendrim janë angazhuar në aktivitete biznesi në tregun e të njëjtit produkt, dhe ku përqendrimi do të çojë në një pjesë të kombinuar të tregut prej 15% ose më shumë. Këto janë raporte horizontale;

(b) një ose më shumë prej palëve në përqendrim janë përfshirë në aktivitete biznesi në një treg produktesh, që është ngritja ose zbritja e një tregu produkti në të cilin është angazhuar një palë tjetër në përqendrim, dhe një nga pjesët individuale ose të kombinuara të tregut në çdo nivel është 25% ose më shumë, pavarësisht nëse ka apo jo raporte ekzistuese furnitor/klient ndërmjet palëve në përqendrim [16]. Këto janë raporte vertikale.

Mbi bazën e përkufizimeve të mësipërme dhe pragjeve të pjesëve të tregut, jepni informacionin e mëposhtëm:[17]

- Identifikoni secilin treg që preket brenda kuptimit të seksionit III, në:
- Nivel të ZEE-së, Komunitar ose EFTA-s;
- Shteteve Anëtare individuale ose shteteve të EFTA-s.

6.2. Përveç kësaj, deklaroni dhe shpjegoni mendimet e palëve në lidhje me objektin e tregut gjeografik përkatës brenda kuptimit të seksionit II që zbatohet në lidhje me çdo treg që preket, të identifikuar më sipër.

IV. Tregje të tjerë në të cilët operacioni i njoftuar mund të ketë një ndikim të rëndësishëm

6.3. Mbi bazën e përkufizimeve të mësipërme, përkthyeri produktin dhe objektin gjeografik të tregjeve të ndryshme nga tregjet e prekura të identifikuar në seksionin 6.1 në të cilët operacioni i njoftuar mund të ketë një ndikim të rëndësishëm, për shembull, ku:

(a) një prej palëve në përqendrim ka një pjesë në treg më të madhe se 25% dhe çdo palë tjetër në përqendrim është një konkurrent potencial në atë treg. Një palë mund të konsiderohet si konkurrent potencial, veçanërisht, nëse ai ka plane për të hyrë në një treg ose ka zhvilluar apo ndjekur këto plane në dy vjetët e fundit;

(b) një prej palëve në përqendrim ka një pjesë në treg më të madhe se 25% dhe çdo palë tjetër në përqendrim ka të drejta të rëndësishme të pronësisë intelektuale për atë treg;

(c) një prej palëve në përqendrim është e pranishme në një treg produkti që është një treg fqinj i lidhur ngushtë me një treg produkti në të cilin është e angazhuar një palë tjetër në përqendrim, dhe pjesët individuale ose të kombinuara të tregut të palëve në një nga këto tregje është 25% më shumë. Tregjet e produktit janë tregje fqinje të lidhur ngushtë kur produktet janë plotësues të njëri-tjetrit [18] ose nëse ata i takojnë një game produktesh që përgjithësisht blihet nga e njëjta kategori klientësh për të njëjtin përdorim përfundimtar [19];

Nëse këta tregje përfshijnë të gjithë ose një pjesë të ZEE-së.

Me qëllim që t'i mundësohet Komisionit të shqyrtojë nga fillimi ndikimin konkurrues të përqendrimit të propozuar në tregjet e identifikuar sipas këtij seksioni 6.3, palët njoftuese ftohen të paraqesin informacionin sipas seksioneve 7 dhe 8 të këtij formulari në lidhje me ata tregje.

SEKSIONI 7

Informacioni mbi tregjet e prekura

Për secilin nga tregjet përkatës të prekur të produktit, për secilin nga tre vitet e fundit financiarë [20]:

(a) për territorin e ZEE-së;

(b) për Komunitetin si një i tërë;

(c) për territorin e shteteve të EFTA-s si një e tërë;

(d) individualisht për çdo Shtet Anëtar dhe shtet të EFTA-s nëse palët në përqendrim kryejnë biznes; dhe

(e) nëse sipas mendimit të palëve njoftuese, tregu përkatës gjeografik është i ndryshëm; paraqisni sa më poshtë:

7.1. Një vlerësim të madhësisë së përgjithshme të tregut në kuptimin e vlerave të shitjeve (në euro) dhe volum (njësi) [21]. Tregoni bazën dhe burimet për llogaritjet dhe paraqisni dokumente sipas rastit për të vërtetuar këtë llogaritje;

7.2. shitjet në vlerë dhe volum, si dhe një vlerësim të pjesëve të tregut, për secilën nga palët në përqendrim;

7.3. një vlerësim të pjesës së tregut në vlerë (dhe, sipas rastit, volum) të të gjithë konkurrentëve (duke përfshirë importuesit) duke marrë parasysh të paktën 5% të tregut gjeografik. Mbi këtë bazë, jepni një vlerësim të indeksit HHI [22] para dhe pas bashkimit, dhe diferencën ndërmjet të dyve (delta) [23]. Tregoni raportin e pjesëve të tregut që përdoren si bazë për të llogaritur HHI-në. Identifikoni burimet e përdorura për të llogaritur këto tregje dhe jepni dokumente sipas rastit për të vërtetuar llogaritjen;

7.4. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të shefit të departamentit ligjor (ose një person tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rastet nëse nuk ka person të tillë, drejtorin ekzekutiv) për konkurrentët e identifikuar sipas 7.3;

7.5. një vlerësim të vlerës dhe volumit të përgjithshëm dhe burimit të importeve nga jashtë territorit të ZEE-së dhe identifikoni:

- (a) raportin e këtyre importeve që dalin nga grupet të cilëve u takojnë palët në përqendrim;
- (b) një vlerësim të masës që çdo kuotë, tarifë ose barrierat pa tarifë të tregtisë ndikojnë këto importe; dhe
- (c) një vlerësim për masën në të cilën transporti dhe shpenzimet e tjera ndikojnë këto importe;

7.6. masën në të cilën tregtia ndërmjet shteteve brenda territorit të ZEE-së ndikohet nga:

- (a) transportimi dhe shpenzimet e tjera; dhe
- (b) barrierat e tjera pa tarifë për tregtinë;

7.7. mënyrën në të cilën palët në përqendrim prodhojnë, caktojnë çmimin dhe shesin produktet dhe/ose shërbimet; për shembull, nëse ato prodhojnë dhe caktojnë çmimet lokalisht apo i shesin nëpërmjet mjeteve lokale të shpërndarjes;

7.8. një krahasim të niveleve të çmimeve në secilin Shtet Anëtar dhe shtet të EFTA-s nga secila palë në përqendrim dhe një krahasim i ngjashëm i niveleve të çmime ndërmjet Komunitetit, shteteve të EFTA-s dhe zonave të tjera ku prodhohen këtë produkte (p.sh, Rusia, Shtetet e Bashkuara, Japonia, Kina ose zona të tjera përkatëse); dhe

7.9 natyrën dhe masën e integritit vertikal të secilës prej palëve në përqendrim krahasuar me konkurruesit e tyre më të mëdhenj.

SEKSIONI 8

Kushtet e përgjithshme në tregjet e prekura

8.1. Identifikoni pesë furnitorët më të mëdhenj [24] të palëve në përqendrim dhe pjesët e tyre individuale të blerjeve nga secili prej këtyre furnitorëve (të lëndëve të para ose mallrave që përdoren për qëllimet e prodhimit të produkteve përkatëse). Jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të drejtorit të departamentit ligjor (ose të një personi tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rastet kur nuk ka person të tillë, të drejtorit ekzekutiv) për secilin nga këta furnitorë.

Struktura e furnizimit në tregjet e prekura

8.2. Shpjegoni kanalet e shpërndarjes dhe rrjetet e shërbimit që ekzistojnë në tregjet e prekura. Për ta bërë këtë, merrni parasysh, sipas rastit, sa më poshtë:

- (a) sistemet e shpërndarjes mbizotëruese në treg dhe rëndësinë e tyre. Në cilën masë kryhet shpërndarja nga palët e treta dhe/ose ndërmarrjet që i takojnë të njëjtit grup si dhe palët e identifikuar në seksionin 4?
- (b) rrjetet e shërbimit (për shembull, mirëmbajtjen dhe riparimin) që mbizotërojnë dhe rëndësinë e tyre në këto tregje. Në cilën masë kryhen këto shërbime nga palët e treta dhe/ose ndërmarrjet që i takojnë të njëjtit grup si dhe palët e identifikuar në seksionin 4?

8.3. Jepni një vlerësim të kapacitetit Komunitar dhe në EFTA për të tre vitet e fundit. Gjatë kësaj periudhe, cili raport i kapacitetit i takon secilës prej palëve në përqendrim dhe cilat janë shkallet e tyre përkatëse të shfrytëzimit të kapacitetit. Sipas rastit, identifikoni vendndodhjen dhe kapacitetin e ambienteve prodhuese të secilës prej palëve në përqendrim në tregjet e prekura.

8.4. Përcaktoni nëse një prej palëve në përqendrim, ose një prej konkurrentëve, kanë produkte që mund të futen në treg në të ardhmen e afërt, ose plane për të zgjeruar (ose kontraktuar) prodhimin ose kapacitetin e shitjeve. Nëse po, jepni një vlerësim të shitjeve të planifikuara dhe pjesëve të tregut të palëve në përqendrim gjatë tre deri pesë viteve të ardhshme.

8.5. Nëse ju mendoni se është i rëndësishëm ndonjë faktor tjetër i anës së furnizimit, duhet të përmendet.

Struktura e kërkesës në tregjet e prekura

8.6. Identifikoni pesë [25] konsumatorët e pavarur më të mëdhenj të palëve në secilin treg të prekur dhe pjesën e tyre individuale të shitjeve të plota për këto produkte që i takojnë secilit prej këtyre konsumatorëve. Jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronikepostës elektronike të drejtorit të departamentit ligjor (ose një personi tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rast se nuk ka person të tillë, të drejtorit ekzekutiv) për secilin prej këtyre konsumatorëve.

8.7. Shpjegoni strukturën e kërkesës në kuptimin e:

- (a) fazave të tregjeve në kuptimin e, për shembull, fillimit, zgjerimit, maturimit dhe rënies, dhe parashikimit të shkallës së rritjes së kërkesës;
- (b) rëndësisë së preferencave të konsumatorëve, për shembull, në kuptimin e besnikërisë ndaj markës, sigurimi i shërbimeve para dhe pas shitjes, sigurimi i një game të gjerë produktesh, ose efektet e rrjetit;
- (c) rolit dhe diferencimit të produktit në kuptimin etributeve ose cilësisë dhe të masës në të cilën produktet e palëve në përqendrim janë zëvendësuese të afërta;
- (d) rolit të shpenzimeve të kalimit (në kuptimin e kohës dhe shpenzimit) për konsumatorët nëse kalojnë nga një furnitor tek tjetri;
- (e) shkallës së përqendrimit ose shpërndarjes së konsumatorëve;
- (f) segmentimit të konsumatorëve në grupe të ndryshme me një përshkrim të “konsumator tipik” për secilin grup;
- (g) rëndësisë së kontratave ekskluzive të shpërndarjes dhe tipave të tjerë të kontratave afatgjata; dhe
- (h) masës në të cilën autoritetet publike, agjencitë qeveritare, ndërmarrjet shtetërore ose organe të ngjashme janë pjesëmarrës të rëndësishëm si burim kërkesë.

Hyrja në treg

8.8. Gjatë pesë viteve të fundit, ka patur ndonjë hyrje të rëndësishme në ndonjë nga tregjet e prekura? Nëse po, identifikoni këto hyrje dhe jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të drejtorit të departamentit ligjor (ose një personi tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rast se nuk ka person të tillë, të drejtorit ekzekutiv), dhe një vlerësim të pjesës faktike të tregut për secilën nga këto hyrje. Nëse një nga palët në përqendrim ka hyrë në një treg të prekur në pesë vitet e fundit, jepni një analizë të barrierave të hasura në hyrje.

8.9. Sipas mendimit të palëve njoftuese, a ka ndërmarrje (duke përfshirë ato që tashmë operojnë jashtë Komunitetit ose ZEE-së) që mund të hyjnë në treg? Nëse po, identifikoni këto hyrje dhe jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të drejtorit të departamentit ligjor (ose një personi tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rast se nuk ka person të tillë, të drejtorit ekzekutiv). Shpjegoni pse kjo hyrje është e mundshme dhe jepni një vlerësim të kohës brenda së cilës kjo hyrje është e ngjashme për të ndodhur.

8.10. Përshkruani faktorët e ndryshëm që ndikojnë në tregjet e prekura, duke shqyrtuar hyrjen nga pikëpamja gjeografike dhe e produktit. Për këtë, merrni në konsideratë, sipas rastit, sa më poshtë:

- (a) shpenzimet e përgjithshme të hyrjes (R&D, prodhimin, ngritjen e sistemeve të shpërndarjes, promovimit, reklamës, shërbimet e kështu me rashë) në një shkallë të njëjtë me një konkurrues të rëndësishëm, duke treguar pjesën e tregut të këtij konkurruesi;
- (b) çdo barrierë ligjore ose rregullore për hyrjen, si autorizimi qeveritar ose caktimi i një standardi një formë të caktuar, si dhe barrierat që rrjedhin nga procedurat e certifikimit të produktit, ose nevojës për të patur një regjistër të verifikueshëm;
- (c) çdo kufizim të krijuar nga ekzistenca e patentave, ekspertizës dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale në këto tregje dhe çdo kufizim të krijuar nga licensimi i këtyre të drejtave;

- (d) masën në të cilën secila prej palëve në përqendrim është zotërues, i licensuar ose licensues i patentave, ekspertizës dhe të drejtave të tjera në tregjet përkatëse;
- (e) rëndësinë e ekonomive të shkallës për prodhimin ose shpërndarjen e produkteve në tregjet e prekura; dhe
- (f) hyrjen tek burimet e furnizimit, si disponueshmëria e lëndëve të para dhe infrastrukturës së nevojshme.

Kërkimi dhe zhvillimi

8.11. Jepni një përshkrim të rëndësishëm të kërkimit dhe zhvillimit në aftësinë e një firme që operon në treg(jet) për të konkurruar në një periudhë afatgjatë. Shpjegoni natyrën e kërkimit dhe zhvillimit dhe tregjet e prekura të kryera nga palët në përqendrim.

Për ta bërë këtë, merrni parasysh, sipas rastit, sa më poshtë:

- (a) tendencat dhe intensitetin e kërkimit dhe zhvillimit [26] në këto tregje dhe për palët në përqendrim;
- (b) kursin e zhvillimit teknologjik për këto tregje gjatë një periudhe kohe të përshtatshme (duke përfshirë zhvillimet në produkte dhe/ose shërbime, procese prodhimi, sisteme shpërndarjeje, e kështu me radhë);
- (c) ndryshimet kryesore që janë bërë në këto tregje dhe ndërmarrjet përgjegjëse për këto ndryshime; dhe
- (d) ciklin e ndryshimit në këto tregje dhe ku palët janë në këtë cikël ndryshimi.

Marrëveshjet bashkëpunuese

8.12. Deri në cilën masë marrëveshjet bashkëpunuese (horizontale, vertikale ose të tjera) ekzistojnë në tregjet e prekura?

8.13. Jepni hollësi për marrëveshjet më të rëndësishme bashkëpunuese të angazhuara nga palët në përqendrim në tregjet e prekura, si kërkimi dhe zhvillimi, licensimi, prodhimi i përbashkët, specializimi, shpërndarja, furnizimi afatgjatë dhe shkëmbimi i marrëveshjeve të informacionit, dhe nëse mendohet e dobishme, paraqisni një kopje të këtyre marrëveshjeve.

Shoqatat tregtare

8.14. Në lidhje me shoqatat tregtare në tregjet e prekura:

- (a) identifikoni ato prej palëve në përqendrim që janë anëtare; dhe
- (b) identifikoni shoqatat tregtare më të rëndësishme të cilave u takojnë konsumatorët dhe furnitorët e palëve në përqendrim.

Jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të personit të përshtatshëm të kontaktit për të gjitha shoqatat tregtare të renditura më sipër.

SEKSIONI 9

Konteksti dhe efikasiteti i përgjithshëm i tregut

9.1. Përshkruani kontekstin botëror të përqendrimit të propozuar, duke treguar pozicionin e secilës prej palëve në përqendrim, jashtë territorit të ZEE-së në kuptimin e madhësisë dhe fuqisë konkurruese.

9.2. Përshkruani se si përqendrimi i propozuar mund të prekë interesat e konsumatorëve të ndërmjetëm dhe fundorë dhe zhvillimin e përparimit teknik dhe ekonomik.

9.3. Nëse ju doni që Komisioni të shqyrtojë, veçanërisht nga fillimi(27), [27] nëse shtimi i efikasitetit që përftohet nga përqendrimi mund të forcojë aftësinë dhe shtysat e subjektit të ri, për të vepruar pozitivisht ndaj konkurrencës në interes të konsumatorëve, jeni të lutur të paraqisni një përshkrim dhe dokumentet shoqëruese të efikasitetit (duke përfshirë kursimet e shpenzimeve, prezantimet e produkteve të reja dhe përmirësimin e shërbimit ose produktit) që

palët parashikojnë që do të rezultojë nga përqendrimi i propozuar në lidhje me çdo produkt përkatës [28]. Për çdo efikasitet të pretenduar paraqisni:

(i) një përshkrim të hollësishëm si përqendrimi i propozuar do të lejojë subjektin e ri të arrijë efikasitetin. Përcakto hapat që palët parashikojnë të marrin për të arritur efikasitetin, rreziqet përkatëse dhe arritjen e rendimentit, kohën dhe shpenzimet e duhura për të arritur atë;

(ii) Nëse normalisht është e mundur, masën e efikasitetit dhe një shpjegim të hollësishëm si është llogaritur kjo masë. Nëse është e rëndësishme, paraqisni gjithashtu një vlerësim të rëndësishme të efikasitetit në lidhje me prezantimet e produkteve të reja ose përmirësimet cilësore. Për efikasitetin që ka të bëjë me kursim shpenzimesh, tregoni veçmas kursimet e shpenzimeve fikse të njëhershme, kursimet e shpenzimeve fikse periodike dhe kursimet variabël të shpenzimeve (në Euro për njësi dhe në Euro në vit);

(iii) masën në të cilën konsumatorët mund të përfitojnë nga efikasiteti dhe një shpjegim të hollësishëm se si është arritur ky konkluzion; dhe

(iv) arsyen pse pala ose palët nuk mund të arrijnë efikasitetin në një masë të njëjtë nëpërmjet një mënyre tjetër, përveç përqendrimit të propozuar dhe në një mënyrë që nuk mund të shkaktojë shqetësime konkurrence.

SEKSIONI 10

Efektet bashkëpunuese të një ndërmarrjeje të përbashkët

10. Për qëllimet e nenit 2 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

(a) A i mbajnë të dy ose më shumë prindër aktivitetet në një masë të konsiderueshme në të njëjtin treg si ndërmarrje e përbashkët ose në një treg që është në ngritje ose zbritje nga ajo e ndërmarrjes së përbashkët apo në një treg fqinj të lidhur ngushtë me këtë treg?(29) [29]

Nëse përgjigja është pohore, jeni të lutur të tregoni për secilin nga tregjet e përmendur këtu:

- xhiron e secilës shoqëri mëmë në vitin paraprirës financiar;
- rëndësinë ekonomike të aktiviteteve të ndërmarrjes së përbashkët në lidhje me këtë xhiro;
- pjesën në treg të secilës shoqëri mëmë.

Nëse përgjigja është negative, jeni të lutur të arsyetoni përgjigjen tuaj.

(b) Nëse përgjigja për (a) është pohore dhe sipas mendimit tuaj krijimi ndërmarrjes së përbashkët nuk sjell bashkërendim ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura që të kufizojë konkurrencën në kuptimin e nenit 81 pika pika 1 të Traktatit të KE-së, jepni arsyet tuaja.

(c) Pavarësisht nga përgjigjet për (a) dhe (b) dhe me qëllim që të sigurohet bërja e një vlerësimi të plotë të çështjes nga Komisioni, jeni të lutur të shpjegoni si zbatohen kriteret e nenit 81 pika 3. Sipas nenit 81 pika 3, dispozitat e nenit 81 pika 1 mund të deklarohen të pazbatueshme, nëse operacioni:

(i) kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjen e mallrave, ose në nxitjen e përparimit teknik dhe ekonomik;

(ii) u lejon konsumatorëve një pjesë të drejtë në përfitimin që del;

(iii) nuk vendos mbi ndërmarrjet përkatëse kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave; dhe

(iv) nuk u ofron këtyre ndërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës në lidhje me një pjesë thelbësore të produkteve në fjalë.

SEKSIONI 11

Deklarimi

Neni 2 pika 2 i Rregullores Zbatuese deklaron që, nëse njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin provë me shkrim që janë të autorizuar të veprojnë. Ky autorizim me shkrim duhet të shoqërojë njoftimin.

Njoftimi duhet të përfundojë me deklarimin e mëposhtëm që duhet të nënshkruhet nga ose në emër të palëve njoftuese:

Pala ose palët njoftuese deklarojnë që, sipas njohurive dhe besimit të tyre të plotë, informacioni i dhënë në këtë njoftim është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe janë dhënë kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të kërkuara nga Formulari CO, dhe të gjitha vlerësimet identifikohen si të tilla dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të mbështetura mbi faktet dhe të gjitha mendimet e shprehura janë të sinqerta.

Ato janë në dijeni të dispozitave të nenit 14 paragrafi 1 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

>PIC FILE= "L_2004133EN.002101.TIF">

- (1) Rregullore e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 janarit 2004, GZ L 24, 29.01.2004, fq. 1. Vëmendja juaj tërhiqet tek dispozitat e Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Europiane (këtu të quajtur "Marrëveshja ZEE"). Shihni veçanërisht nenin 57 të Marrëveshjes ZEE, pika 1 e Shtojcës XIV të Marrëveshjes ZEE dhe Protokollit 4 të Marrëveshjes ndërmjet shteteve të EFTA-s mbi ngritjen e një Autoriteti Mbikëqyrjeje dhe një Gjykate Drejtësie, si dhe Protokollin 21 dhe 24 të Marrëveshjes ZEE dhe nenin 1 të Shënimeve të Miratuara të Protokollit që përshtat Marrëveshjen ZEE. Çdo referencë në shtetet e EFTA-s kuptohet për ata shtete të EFTA-s që janë Palë Kontraktuese në Marrëveshjen e EEA. Që nga 1 maji 2004, këto shtete janë Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia.
- (2) Termi "përqendrim" është përkufizuar në nenin 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet dhe termi "dimension Komunitar" në nenin 1 të saj. Për më tepër, neni 4 pika 5 parashikon që në rrethana të caktuara ku pragjet e xhiros Komunitare nuk arrihen, palët njoftuese mund t'i kërkojnë Komisionit ta trajtojë përqendrimin e tyre të propozuar sikur të ketë një dimension Komunitar.
- (3) Shih nenin 10 pika 1 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.
- (4) Shih nenin 10 pika 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.
- (5) Shih nenin 4 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.
- (6) Shih, veçanërisht, nenin 122 të Marrëveshjes ZEE, nenin 9 të Protokollit 24 të Marrëveshjes së ZEE dhe nenin 17 pika 2 të Kapitullit XIII të Protokollit 4 të Marrëveshjes ndërmjet shteteve të EFTA-s mbi ngritjen e një Autoriteti Mbikëqyrjeje dhe një Gjykate Drejtësie (Marrëveshja ESA).
- (7) Shih seksionin 6.III për përkufizimin e tregjeve të prekur.
- (8) Kjo përfshin shoqërinë e synuar në rastin e një oferte konkurruese, rast në të cilin hollësitë duhet të përfshihen në masën që është e mundur.
- (9) Shih njoftimin e Komisionit mbi konceptin e ndërmarrjeve të interesuara.
- (10) Shih në përgjithësi njoftimin e Komisionit mbi llogaritjen e xhiros. Xhiroja e palës përftuese ose e palëve në përqendrim duhet të përfshijë xhiron e bashkuar të të gjitha ndërmarrjeve brenda kuptimit të nenit 5 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Xhiroja e palës ose palëve të përftuara duhet të përfshijë xhiron në lidhje me pjesët që i nënshtrohen transaksionit brenda kuptimit të nenit 5 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Dispozita të veçanta ndodhen në nenet 5 pikat 3, 4 dhe 5 të Rregullores së KE-së për Bashkimet për kredinë, sigurimet dhe institucione të tjera financiare dhe ndërmarrjet e përbashkëta.
- (11) Shih nenin 57 të Marrëveshjes ZEE dhe veçanërisht nenin 2 pika 1 të Protokollit 24 të Marrëveshjes ZEE. Një rast kualifikohet si rast bashkëpunimi, nëse xhiroja e kombinuar e ndërmarrjeve të interesuara në territorin e shteteve të EFTA-s është i barabartë me 25% ose më shumë të xhiros së tyre të plotë brenda territorit që mbulohet nga Marrëveshja ZEE; ose secila prej të paktën dy ndërmarrjeve të interesuara ka një xhiro që i kalon 250 milion Euro në territorin e shteteve të EFTA-s; ose përqendrimi mund të krijojë ose forcojë një pozicion dominues, si rezultat i të cilit konkurrenca efektive do të pengohej në masë të konsiderueshme në territoret e shteteve të EFTA-s ose një pjesë të rëndësishme të tyre.
- (12) Shih nenin 3 pikat 3, 4 dhe 5 dhe nenin 5 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.
- (13) Shih seksionin 6 për përkufizimin e tregjeve të prekura.
- (14) Siç shpjegohet edhe në pjesët hyrëse 1.1 dhe 1.3(g), në kontekstin e paranoftimit, juve mund t'u duhet të diskutoni me Komisionin, se në cilën masë do të ishte e përshtatshme përjashtimi (heqja dorë) nga paraqitja e dokumenteve të kërkuara. Nëse kërkohet heqje dorë nga përgjegjësia, Komisioni mund të përcaktojë dokumentet që duhet të paraqiten në një rast të caktuar në një kërkesë për informacion sipas nenit 11 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.
- (15) Shih Shënimin e Komisionit mbi përkufizimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit Komunitar për konkurrencën.
- (16) Për shembull, nëse një palë në bashkim ka një pjesë tregu më të madhe se 25% në një treg që është në ngritje, në një treg në të cilin vepron pala tjetër, atëherë të dyja tregjet në ngritje dhe në ulje janë tregje të prekur. Po kështu, nëse një shoqëri e integruar vertikalisht bashkohet me një palë tjetër që vepron në një nivel në zbritje dhe bashkimi çon në një pjesë tregu të kombinuar në zbritje prej 25% ose më shumë, atëherë të dy tregjet në ngritje dhe në zbritje janë tregjet e prekura.
- (17) Siç shpjegohet në pjesët hyrëse 1.1 dhe 1.3(g), në kontekstin e paranoftimit, ju mund të doni të diskutoni me Komisionin, deri në cilën masë përjashtimi (heqja dorë) nga paraqitja e informacionit të kërkuar do të ishte e përshtatshme për tregje të caktuara të prekur, ose për tregje të tjerë të caktuara (siç përkrahuhet tek IV).
- (18) Produktet (ose shërbimet) quhen plotësuese, nëse, për shembull, përdorimi (ose konsumimi) i një produkti supozon përdorimin thelbësor (ose konsumimin) e produktit tjetër, siç janë kapëset për makinën kapëse, dhe boja e printimit për printerat.
- (19) Shembujt e produkteve që i takojnë një game të tillë do të ishin uiski dhe xhini që u shitet bareve dhe restoranteve, dhe materiale të ndryshme për paketimin e një kategorie të caktuar të mallrave që u shiten prodhuesve të këtyre mallrave.
- (20) Pa cenuar nenin 4 pika 2 të Rregullores Zbatuese.

(21) Vlera dhe volumi i një tregu duhet të reflektojnë prodhimin, duke zbritur eksportet dhe shtuar importet për zonat gjeografike nën shqyrtim. Nëse është e gatshme, jeni të lutur të jepni informacion të ndarë mbi importet dhe eksportet përkatësisht sipas vendit të origjinës dhe destinacionit.

(22) HHI do të thotë Indeksi Herfindahl-Hirschman, një masë e përqendrimit të tregut. HHI llogaritet duke mbledhur katrorët e pjesëve individuale të tregut të të gjitha firmave në treg. Për shembull, një treg që ka pesë firma me pjesë në treg prej përkatësisht 40%, 20%, 15%, 15%, dhe 10%, ka një HHI prej 2550 ($40^2 + 20^2 + 15^2 + 15^2 + 10^2 = 2550$). HHI ndryshon nga gati zero (në një treg të ndarë) në 10000 (në rastin e monopolit të pastër). HHI pas bashkimit llogaritet mbi supozimin e punës që pjesët individuale në treg të shoqërive ndryshojnë. Megjithëse është më mirë të përfshihen të gjitha firmat në llogaritje, mungesa e informacionit në lidhje me firmat shumë të vogla mund të mos jetë i rëndësishëm, pasi këto firma nuk ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mbi HHI.

(23) Rritja e përqendrimit sipas matjes nëpërmjet HHI-së mund të llogaritet në mënyrë të pavarur për të gjithë përqendrimin e tregut duke dyfishuar produktin e pjesëve të tregut të firmave që bashkohen. Për shembull, një bashkim i dy firmave me pjesë në treg prej 30% dhe 15% përkatësisht do të rrisnin HHI-së me 900 ($30 \times 15 \times 2 = 900$). Shpjegimi për këtë teknikë është si më poshtë: para bashkimit, pjesët e tregut të firmave që bashkohen kontribuojnë në HHI nëpërmjet katrorëve të tyre individualisht: $(a)^2 + (b)^2$. Pas bashkimit, kontributi është katrori i shumave të tyre: $(a + b)^2$, që është e barabartë me $(a)^2 + (b)^2 + 2ab$. Rritja në HHI përfaqësohet me $2ab$.

(24) D.m.th, furnitorët që nuk janë filiale, agjentë ose ndërmarrje që janë pjesë e grupit të palës në fjalë. Përveç atyre pesë furnitorëve të pavarur, palët njoftuese, nëse ato e mendojnë të nevojshme për një vlerësim të saktë të çështjes, identifikojnë furnitorët e brendshëm. E njëjta zbatohet për 8.6 në lidhje me konsumatorët.

(25) Eksperienca ka treguar që shqyrtimi i çështjeve komplekse kërkon zakonisht më shumë hollësi kontakti për klientët. Në kuadrin e kontakteve para njoftimit, shërbimet e Komisionit mund të kërkojnë më shumë hollësi kontakti për klientët për tregje të caktuara të prekura.

(26) Intensiteti i kërkimit dhe zhvillimit përkufizohet si shpenzim i zhvillimit të kërkimit si një raport i xhiros.

(27) Duhet të vihet re që dhënia e informacionit sipas seksionit 9.3 është vullnetare. Palëve nuk u kërkohet të ofrojnë ndonjë arsyetim për mosmbushjen e këtij seksioni. Mosdhënia e informacionit mbi efikasitetin nuk do të merret me kuptimin që përqendrimi i propozuar nuk krijon efikasitet, ose që arsyet për përqendrimin janë për rritjen e fuqisë së tregut. Mosdhënia e informacionit të kërkuar për efikasitet në fazën e njoftimit nuk pengon dhënien e informacionit në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, sa më parë të jepet informacioni, aq më mirë Komisioni mund të verifikojë pretendimin e efikasitetit.

(28) Për udhëzime të mëtejshme për vlerësimin e efikasitetit, shih shënimin e Komisionit për vlerësimin e bashkimeve horizontale.

(29) Për përkufizimet e tregut referojuni Seksionit 6.S

1. Hyrje

1.1. Qëllimi i formularit të shkurtër

Formulari i Shkurtër përcakton informacionin që duhet të jepet nga palët njoftuese kur paraqitet njoftimi tek Komisioni Europian i Bashkimeve, përfitimeve ose përqendrimeve të caktuara të propozuara që nuk duket se shkaktojnë shqetësime konkurrence.

Për mbushjen e këtij formulari, vëmendja tuaj tërhiqet tek Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 139/2004 (këtu quhet Rregullorja e KE-së për Bashkimet) dhe Rregullorja e Komisionit (KE) nr. xx/2004 (këtu quhet “Rregullorja Zbatuese”), të cilës i bashkëngjitet ky formular [1]. Teksti i këtyre rregulloreve, si dhe i dokumenteve të tjerë përkatës, mund të gjenden në faqen e Konkurrencës së adresës së internetit “Europa” të Komisionit.

Si rregull i përgjithshëm, Formulari i Shkurtër për qëllimin e njoftimit të bashkimeve, ë përqendrimeve, nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:

1. në rastin e një ndërmarrjeje të përbashkët, ndërmarrja e përbashkët nuk ka aktivitete faktike ose të parashikuara brenda territorit të Zonës Ekonomike Europiane (ZEE). Këto raste ndodhin kur:

(a) xhiroja e ndërmarrjes së përbashkët dhe/ose xhiroja e aktiviteteve të kontribuar është më pak se 100 milion Euro në territorin EEA; dhe

(b) vlera totale e sendeve pasurore të transferuara tek ndërmarrja e përbashkët është më pak se 100 milion Euro në territorin ZEE;

2. asnjë nga palët në përqendrim nuk është përfshirë në aktivitete biznesi në të njëjtin produkt përkatës dhe treg gjeografik (pa mbivendosje horizontale), ose në treg që është në ngritje ose zbritje të një tregu në të cilin është e përfshirë një palë tjetër në përqendrim (pa raport vertikal);

3. dy ose më shumë palë në përqendrim janë përfshirë në aktivitete biznesi në të njëjtin produkt përkatës dhe treg gjeografik (raport horizontal), me kusht që pjesa e tyre e kombinuar e tregut është më pak se 15%; dhe/ose një ose më shumë prej palëve në përqendrim janë përfshirë në aktivitete biznesi në një treg produkti që është në ngritje ose në zbritje të një tregu produkti në të cilin është përfshirë një palë tjetër në përqendrim (raporte vertikale), dhe me kusht që asnjë prej pjesëve të tyre individuale ose të kombinuara të tregut në cilindo nivel është 25% ose më shumë; ose

4. një palë do të përftojë kontroll të vetëm të një ndërmarrjeje mbi të cilën ajo ka patur kontroll të përbashkët. Komisioni mund të kërkojë një njoftim me formular të plotë, nëse duket që kushtet për përdorimin e Formularit të Shkurtër nuk përmbushen, ose, përjashtimisht, nëse ato përmbushen, Komisioni vendos, megjithatë, që një njoftim sipas Formularit CO është i nevojshëm për një hetim të përshtatshëm të shqetësimeve të mundshme të konkurrencës.

Shembuj të rasteve, ku një njoftim sipas Formularit CO mund të jetë i nevojshëm, janë përqendrimet ku është e vështirë të përcaktohen tregjet përkatëse (për shembull, në tregjet në zhvillim ose ku nuk ka praktikë të vendosur çështjesh); nëse një palë është një subjekt i ri ose potencial, ose një zotërues i rëndësishëm patente; nëse nuk është e mundur të përcaktohen rregullisht pjesët e tregut të palëve; në tregjet me barriera të lartë hyrjeje, me një shkallë të lartë përqendrimi ose me probleme të njohura konkurrence; nëse të paktën dy palë në përqendrim janë të pranishme në tregjet fqinjë ngushtësisht të lidhur [2]; dhe në përqendrime nëse del çështja e bashkërendimit, sipas parashikimit

të nenit 2 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Po kështu, një njoftim sipas Formularit CO mund të kërkohet në rastin e një pale që përfton kontroll të vetëm të një ndërmarrjeje të përbashkët, në të cilën ajo ka tashmë kontroll të përbashkët, nëse pala përfutuese dhe ndërmarrja e përbashkët së bashku kanë një pozicion të fortë në treg, ose ndërmarrja e përbashkët dhe pala përfutuese ka në pozicione të forta në tregjet e lidhura vertikalisht.

1.2. Kthimi tek njoftimi i Formularit CO të plotë

Në vlerësimin nëse një përqendrim mund të njoftohet sipas Formularit të Shkurtër, Komisioni siguron që të gjitha rrethanat përkatëse të përcaktohen me qartësi të mjaftueshme. Në këtë aspekt, përgjegjësia për të dhënë informacion të saktë dhe të plotë u takon palëve njoftuese.

Nëse, pasi është njoftuar një përqendrim, Komisioni është i mendimit që rasti nuk është i përshtatshëm për njoftim sipas Formularit të Shkurtër, ai mund të kërkojë një njoftim të plotë, ose sipas rastit të pjesshëm, sipas Formularit CO. Ky mund të jetë rasti kur:

- duket që nuk përmbushen kushtet për përdorimin e Formularit të Shkurtër;
- megjithëse kushtet për përdorimin e Formularit të Shkurtër përmbushen, një njoftim i plotë ose i pjesshëm sipas Formularit CO duket të jetë i nevojshëm për një hetim të përshtatshëm të shqetësimeve të mundshme për konkurrencën ose për të vërtetuar që transaksioni është një përqendrim në kuptimin e nenit 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet;
- Formulari i Shkurtër përmban informacion të pasaktë dhe të gabuar;
- një Shtet Anëtar shpreh shqetësime thelbësore për konkurrencën në lidhje me përqendrimin e njoftuar brenda 15 ditëve pune nga marrja e kopjes së njoftimit; ose
- një palë e tretë shpreh shqetësime thelbësore për konkurrencën brenda afatit kohor të caktuar nga Komisioni për këto komente.

Në këto raste, njoftimi mund të trajtohet si i paplotë në një aspekt material në përputhje me nenin 5 pika 2 të Rregullores Zbatuese. Komisioni do të informojë palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre për këtë me shkrim dhe pa vonesë. Njoftimi hyn në fuqi në datën në të cilën merret i gjithë informacioni i kërkuar.

1.3. Rëndësia e kontakteve para njoftimit

Eksperiencia ka treguar që kontaktet para njoftimit janë tepër të vlefshme për palët njoftuese dhe për Komisionin në caktimin e sasisë së saktë të informacionit të kërkuar në një njoftim. Po ashtu, në rastet ku palët duan të paraqesin një njoftim me Formular të Shkurtër, ato këshillohen të angazhohen në kontakte para njoftimit me Komisionin me qëllim që të diskutohet nëse një rast është i përshtatshëm për të përdorur një Formular të Shkurtër. Palët njoftuese mund t'i referohen praktikave më të mira të Komisionit mbi zhvillimin e procedimeve të kontrollit të bashkimeve të KE-së, që shërbejnë si udhëzim për kontaktet e paranjoftimit dhe përgatitjen e njoftimeve.

1.4. Kush duhet të njoftojë

Në rastin e një bashkimi brenda kuptimit të nenit 3 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet ose të përfutimit të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrjeje, brenda kuptimit të nenit 3 pika 1 gërma b të Rregullores së KE-së për Bashkimet, njoftimi kryhet së bashku nga palët në bashkim ose nga ato që përfutjnë kontroll të përbashkët, sipas rastit [3].

Në rastin e përfutimit të një zotërimi kontrolli në një ndërmarrje nga një tjetër, njoftimin duhet ta kryejë përfutuesi.

Në rastin e një oferte publike për të përfutuar një ndërmarrje, njoftimin duhet ta bëjë ofertuesi.

Secila palë që bën njoftimin është përgjegjëse për saktësinë e informacionit që ajo jep.

1.5. Kërkesa për një njoftim të saktë dhe të plotë

I gjithë informacioni i kërkuar nga ky formular duhet të jetë i saktë dhe i plotë. Informacioni i kërkuar duhet të jepet në seksionin e përshtatshëm në këtë formular.

Veçanërisht duhet të vini re që:

(a) Në përputhje me nenin 10 pika 1 të Rregullores së KE-së për Bashkimet dhe nenin 5 pikat 2 dhe 4 të Rregullores Zbatuese, afatet kohore të Rregullores së KE-së për Bashkimet në lidhje me njoftimin nuk janë në fuqi derisa nuk është marrë nga Komisioni i gjithë informacioni që duhet të paraqitet me njoftimin. Kjo kërkesë është për të siguruar që Komisioni është në gjendje të vlerësojë përqendrimin e njoftuar brenda afateve kohore rigoroze të parashikuara nga Rregullorja e KE-së për Bashkimet.

(b) Palët njoftuese duhet të verifikojnë, në kuadrin e përgatitjes së njoftimit të tyre, që emrat dhe numrat e kontaktit, dhe veçanërisht numrat e faksit dhe adresat e postës elektronike të dhëna Komisionit të jenë të sakta, funksionale dhe të përditësuara.

(c) Informacioni i pasaktë ose i gabuar në njoftim do të konsiderohet të jetë informacion i paplotë (neni 5 pika 4 i Rregullores Zbatuese).

(d) Nëse një njoftim është i paplotë, Komisioni do të informojë palët e tjera njoftuese ose përfaqësuesit e tyre me shkrim dhe pa vonesë. Njoftimi do të hynë në fuqi në datën në të cilën informacioni i plotë dhe i saktë merret nga Komisioni (neni 10 pika 1 i Rregullores së KE-së për Bashkimet, neni 5 pikat 2 dhe 4 i Rregullores Zbatuese).

(e) Sipas nenit 14 pika 1 gërma a e Rregullores së KE-së për Bashkimet, palët njoftuese që, me qëllim ose pakujdesi, japin informacion të pasaktë ose të gabuar, mund të marrin gjoba deri në 1% të xhiros së plotë të ndërmarrjes përkatëse. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 6 pika 3 gërma a dhe nenin 8 pika 6 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet, Komisioni mund të shfuqizojë vendimin e tij mbi përputhshmërinë e një përqendrimi të njoftuar nëse bazohet në informacion të pasaktë për të cilin është përgjegjëse një nga ndërmarrjet.

(f) Ju mund të kërkonte me shkrim që Komisioni të pranojë që njoftimi është i plotë pavarësisht mosdhënies së informacionit të kërkuar nga ky formular, nëse ky informacion nuk u jepet juve normalisht pjesërisht ose plotësisht (për shembull, për shkak të mospasjes së informacionit mbi shoqërinë e synuar gjatë ofertës konkurruese).

Komisioni e shqyrton një kërkesë të tillë, me kusht që ju të jepni arsyet për mospasjen e atij informacioni dhe të jepni vlerësimet tuaja më të mira për të dhënat që mungojnë së bashku me burimet për vlerësimet. Nëse është e mundur duhet të jepen edhe tregues nëse një informacion i kërkuar që ju nuk mund ta keni mund të gjendet nga Komisioni.

(g) Ju mund të kërkonte me shkrim që Komisioni të pranojë që njoftimi është i plotë pavarësisht mosdhënies së informacionit të kërkuar nga ky formular, nëse ju mendoni që një informacion i caktuar i kërkuar mund të mos jetë i nevojshëm për shqyrtimin e çështjes nga Komisioni.

Komisioni e shqyrton këtë kërkesë, me kusht që ju të jepni arsye të përshtatshme pse ai informacion nuk është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për hetimin e tij në operacionin e njoftuar. Ju duhet ta shpjegoni këtë gjatë kontakteve tuaja para njoftimit me Komisionin, dhe të paraqisni një kërkesë me shkrim për një heqje dorë, duke i kërkuar Komisionit të heqë detyrimin për dhënie e atij informacioni, në përputhje me nenin 4 pika 2 të Rregullores Zbatuese.

1.6. Si bëhet njoftimi

Njoftimi duhet të kryhet në një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit Europian. Kjo gjuhë do të jetë pastaj gjuha e procedimit për të gjitha palët njoftuese. Nëse njoftimet bëhen në përputhje me nenin 12 të Protokollit 24 të Marrëveshjes së ZEE-së në një gjuhë zyrtare të një Shteti të EFTA-s që nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, njoftimi duhet që njëkohësisht të plotësohet me një përkthim në një gjuhë zyrtare të Komunitetit.

Informacioni i kërkuar në këtë formular duhet të caktohet duke përdorur seksionet dhe numrat e paragrafëve të formularit, duke nënshkruar një deklaratë sipas parashikimit në Seksionin 9, dhe duke bashkangjitur dokumentacionin shoqërues. Për mbushjen e Seksionit 7 të këtij formulari, palët njoftuese ftohen të shqyrtojnë nëse, për qëllime qartësie, ky seksion paraqitet më mirë në rend numerik, ose nëse informacioni mund të grupohet së bashku për secilin treg të raportueshëm individual (ose grup i tregjeve të raportueshëm).

Për hir të qartësisë, një pjesë e informacionit mund të futet në shtojca. Megjithatë, është thelbësore që pjesët kryesore të informacionit, veçanërisht informacioni për pjesët e tregut për palët dhe konkurruesit e tyre më të mëdhenj të prezantohen në strukturën e këtij formulari. Shtojcat e këtij formulari do të përdoren vetëm për të plotësuar informacionin e dhënë në vetë formularin.

Hollësitë e kontaktit duhet të jepen në një format të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën e Komisionit (DP Konkurrencës). Për një proces të saktë hetimor, është thelbësore që hollësitë e kontaktit të jenë të sakta. Disa raste të hollësive të pasakta të kontaktit mund të jetë shkak për deklarimit të njoftimit të paplotë. Dokumentet shoqëruese duhet të paraqiten në një gjuhë origjinale; nëse kjo nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, ato duhet të përkthehen në gjuhën e procedimit (neni 3 pika 4 e Rregullores Zbatuese).

Dokumentet shoqëruese mund të jenë origjinalet ose kopje të origjinaleve. Në rastin e fundit, pala njoftuese duhet të vërtetojë që ato janë të vërteta dhe të plota.

Një origjinal dhe 35 kopje të Formularit të Shkurtër dhe dokumenteve shoqëruese duhet t'i paraqiten Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën e Komisionit.

Njoftimi paraqitet në adresën e përmendur në nenin 23 pika 1 të Rregullores Zbatuese dhe në formatin e përcaktuar nga Komisioni herë pas here. Kjo adresë botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Njoftimi duhet t'i jepet Komisionit në ditën e punës së përcaktuara në nenin 24 të Rregullores Zbatuese. Me qëllim që t'i mundësohet atij regjistrimi në të njëjtën ditë, ai duhet të paraqitet para orës 17. 00 të hënë deri të enjten, dhe para orës 16. 00 të premten dhe në ditët e punës para ditëve të festave zyrtare dhe ditëve të festave të tjera sipas përcaktimit nga Komisioni dhe botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Udhëzimet e sigurisë të dhëna në faqen e internetit e DP Konkurrencës duhet të respektohen.

1.7. Konfidencialiteti

Neni 287 e traktatit dhe neni 17 pika 2 e Rregullores së KE-së për Bashkimet si dhe dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së ZEE-së [4] i kërkojnë Komisionit, Shteteve Anëtare dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së EFTA-s dhe Shteteve të EFTA-s, nëpunësve të tyre dhe punonjësve të tjerë për të mos deklaruar informacionin që ata e kanë përfutur gjatë zbatimit të rregullores të llojit që i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional. I njëjti parim duhet të zbatohet për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet palëve njoftuese.

Nëse ju besoni që interesat tuaja do të dëmtohen nëse një pjesë e informacionit që juve u kërkohet të paraqisni do të botohej ose do t'u deklarohej palëve të tjera, paraqiteni këtë informacion të ndarë me secilën faqe qartësisht të shënuar "Sekrete Biznesi". Ju duhet të jepni edhe arsyet se pse ky informacion nuk duhet të deklarohet ose botohet.

Në rastin e bashkimeve ose përfitimeve të përbashkëta, ose në raste të tjera ku njoftimi kryhet nga më shumë se një prej palëve, sekretet tregtare duhet të paraqiten nën një titull të veçantë dhe të bëhet referencë tek to në njoftim si një aneks. Të gjitha këto anekse duhet të përfshihen në deklaratë me qëllim që njoftimi të konsiderohet i plotë.

1.8. Përkufizimet dhe udhëzimet për qëllimet e këtij Formulari

Pala ose palët njoftuese: në rastet kur një njoftim paraqitet nga vetëm një prej ndërmarrjeve që është palë në një operacion, “palët njoftuese” përdoret për t’u referuar vetëm ndërmarrjes që faktikisht paraqet njoftimin.

Pala(ët) në përqendrim ose palët: këto terma kanë të bëjnë me palët përfutuese dhe të përtuara, ose me palët që bashkohen, duke përfshirë të gjitha ndërmarrjet në të cilat po përftohet një interes kontrolli ose që i nënshtrohet një oferte publike.

Përveç kur përcaktohet ndryshe, termat palë(t) njoftuese dhe palë(t) në përqendrim përfshijnë të gjitha ndërmarrjet që u takojnë të njëjtëve grupe si ato palë.

Vit: të gjitha referencat tek fjala vit në këtë formular duhet të kuptohet si vit kalendarik, nëse nuk përcaktohet ndryshe. I gjithë informacioni i kërkuar në këtë formular, nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet t’i takojë vitit që paraprin atë të njoftimit.

Të dhënat financiare të kërkuara në Seksionet 3.3 deri 3.5 duhet të jepen në Euro me kurset mesatare të këmbimit që mbizotërojnë për vite ose periudha të tjera në fjalë.

Të gjitha referencat që gjenden në këtë formular janë për nenet dhe paragrafët përkatës të Rregullores së KE-së për Bashkimet, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

1.9. Dhënia e informacionit punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre

Komisioni do të donte të tërhiqte vëmendjen për detyrimet që mund t’u nënshtrohen palët në një përqendrim në bazë të rregullave Komunitare dhe/ose të brendshme të informacionit dhe këshillimit, në lidhje me transaksionet e një natyre bashkuese kundrejt punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre.

SEKSIONI 1

Përshkrimi i përqendrimit

1.1. Jepni një përshkrim të shkurtër të përqendrimit, duke përcaktuar palët në përqendrim, natyrën e përqendrimit (për shembull, bashkim, përfitim ndërmarrje e përbashkët) zonat në e aktivitetit të palëve njoftuese, tregjet në të cilat përqendrimi do të ketë ndikim (duke përfshirë tregjet kryesorë të raportueshëm [5]), dhe argumentet strategjike dhe ekonomike për përqendrimin.

1.2. Jepni një përmbledhje (deri në 500 fjalë) të informacionit të dhënë në Seksionin 1.1. Mendohet që kjo përmbledhje të botohet në adresën e internetit të Komisionit në datën e njoftimit. Përmbledhja duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të mos përmbajë informacion konfidencial ose sekrete tregtare.

SEKSIONI 2

Informacioni për palët

2.1. Informacion për palën(t) njoftuese

Jepni hollësi për:

2.1.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

2.1.2. natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

2.1.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike, dhe pozicionin që mbahet nga personi i përshtatshëm i kontaktit; dhe

2.1.4 adresën postare të shërbimit të palës njoftuese (ose secilës prej palëve njoftuese) tek e cila mund të dorëzohen dokumentet dhe veçanërisht, vendimet e Komisionit. Emri, adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit të një personi në këtë adresë që është i autorizuar për të pranoje dorëzimin.

2.2. Informacioni mbi palët [6] në përqendrim.

Për secilën palë në përqendrim (përveç palës ose palëve njoftuese) jepni hollësi për:

2.2.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

2.2.2. natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

2.2.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike, dhe pozicionin që mbahet nga personi i përshtatshëm i kontaktit; dhe

2.2.4 adresën postare të shërbimit të palës (ose secilës prej palëve) tek e cila mund të dorëzohen dokumentet dhe veçanërisht, Vendimet e Komisionit. Emri, adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit të një personi në këtë adresë që është i autorizuar të pranojë dorëzimin.

2.3. Emërimi i përfaqësuesve

Nëse njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin provë me shkrim që ata janë të autorizuar të veprojnë. Prova me shkrim duhet të mbajë emrin dhe pozicionin e personave që japin këtë autorizim.

Jepni hollësitë e mëposhtme të informacionit të çdo përfaqësuesi që janë autorizuar të veprojnë për një prej palëve në përqendrim, duke treguar që ata përfaqësojnë:

2.3.1. emrin e përfaqësuesit;

2.3.2. adresën e përfaqësuesit;

2.3.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të personit që do të kontaktohet; dhe

2.3.4. adresën postare të përfaqësuesit (nëse ka në Bruksel) ku mund të dërgohet korrespondenca dhe dorëzohen dokumentet.

SEKSIONI 3

Hollësitë e përqendrimit

3.1 Përshkruani natyrën e përqendrimit që njoftohet. Për të bërë këtë, deklaroni:

(a) nëse përqendrimi i propozuar është një bashkim i plotë ligjor, një përfitim i kontrollit të vetëm ose të përbashkët, një ndërmarrje e përbashkët tërësisht funksionale brenda kuptimit të nenit 3 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet ose në kontratë apo mjet tjetër për dhënien e kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë brenda kuptimit të nenit 3 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet;

(b) nëse të gjitha ose pjesë të palëve i nënshtrohen përqendrimit;

(c) një shpjegim i shkurtër i strukturës ekonomike dhe financiare të përqendrimit;

(d) nëse një ofertë publike për letrat me vlerë të një palë nga një tjetër ka mbështetjen e bordeve mbikëqyrës të menaxhimit të së parës ose organe të tjera që ligjërisht përfaqësojnë atë palë;

(e) datën e propozuar ose të pritshme të çdo ngjarjeje madhore të planifikuar për të realizuar përfundimin e përqendrimit;

(f) strukturën e propozuar të pronësisë dhe kontrollin pas përfundimit të përqendrimit;

(g) çdo mbështetje financiare ose tjetër që merret nga një burim i caktuar (duke përfshirë autoritetet publike) nga një prej palëve dhe natyrën dhe shumën e kësaj mbështetjeje; dhe

(h) sektorët ekonomikë të përfshirë në përqendrim.

3.2 Deklaroni vlerën e transaksionit (çmimin e blerjes ose vlerën e të gjitha sendeve pasurore të përfshira, sipas rastit);

3.3. Për secilën prej ndërmarrjeve që preken nga përqendrimi [7] jepni të dhënat e mëposhtme [8] për vitin e fundit financiar:

3.3.1. xhiron botërore;

3.3.2. xhiron Komunitare;

3.3.3. xhiron brenda EFTA-s;

3.3.4. xhiron në secilin Shtet Anëtar;

3.3.5. xhiron në çdo Shtet të EFTA-s;

3.3.6. Shtetin Anëtar, nëse ka, në të cilin arrihet më shumë se dy të tretat e xhiros Komunitare, dhe

3.3.7. Shtetin e EFTA-s, nëse ka, në të cilin arrihet më shumë se dy të tretat e xhiros së EFTA-s.

3.4. Për qëllimet e nenit 1 pika 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, nëse operacioni nuk arrin pragjet e parashikuar në nenin 1 pika 2, jepni të dhënat e mëposhtme për vitin e fundit financiar:

3.4.1. Shtetet Anëtare, nëse ka, ku xhirua e kombinuar e plotë e të gjitha ndërmarrjeve përkatëse është më shumë se 100 milion Euro; dhe

3.4.2. Shtetet Anëtare, nëse ka, ku xhirua e plotë e secilit prej të paktën dy prej ndërmarrjeve përkatëse është më shumë se 35 milion Euro.

3.5. Për qëllimet e përcaktimit nëse përqendrimi kualifikohet si një rast i bashkëpunimit EFTA [9], jepni informacionin e mëposhtëm në lidhje me vitin e fundit financiar:

3.5.1. është xhirua e kombinuar e ndërmarrjeve përkatëse në territorin e Shteteve të EFTA-s e barabartë me 25% ose më shumë e xhiros së tyre të plotë në territorin e ZEE-së?

3.5.2. a ka të paktën secila prej dy ndërmarrjeve përkatëse një xhiro që e kalon 250 milion Euro në territorin e Shteteve të EFTA-s?

3.6. Në rastin kur veprimi ka të bëjë me përfitim të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrjeje të përbashkët, jepni informacionin e mëposhtëm:

3.6.1. xhiron e ndërmarrjes së përbashkët dhe/ose xhiron e aktiviteteve të kontribuar në ndërmarrjen e përbashkët; dhe/ose

3.6.2. vlera totale e sendeve pasurore të transferuara në ndërmarrjen e përbashkët.

3.7. Përshkruani argumentimin ekonomik të përqendrimit.

SEKSIONI 4

Pronësia dhe kontrolli [10]

Për secilin nga palët në përqendrim, jepni një listë të të gjitha ndërmarrjeve që i takojnë të njëjtit grup.

Kjo listë duhet të përfshijë:

4.1. të gjitha ndërmarrjet ose personat që kontrollojnë këto palë, drejtpërdrejt ose jo;

4.2. të gjitha ndërmarrjet që veprojnë në një treg të raportueshëm [11] që kontrollohen, drejtpërdrejt ose jo:

(a) nga këto palë;

(b) nga një ndërmarrje tjetër e identifikuar në 4.1.

Për secilën hyrje të renditur më sipër, duhet të përcaktohen natyra dhe mjetet e kontrollit.

Informacioni i kërkuar në këtë seksion mund të ilustruhet nga përdorimi i organigramave dhe diagrameve për të treguar strukturën e pronësisë dhe kontrollit të ndërmarrjeve.

SEKSIONI 5

Dokumentacioni shoqërues

Palët njoftuese duhet të paraqesin sa më poshtë:

5.1. kopje të versioneve përfundimtare ose të fundit të të gjithë dokumenteve që realizojnë përqendrimin, me marrëveshje ndërmjet palëve në përqendrim, përfitim e një zotërim kontrolli ose ofertë publike; dhe

5.2. kopje të raporteve dhe llogarive vjetore të fundit të të gjitha palëve në përqendrim.

SEKSIONI 6

Përkufizimet e tregut

Produkti përkatës dhe tregjet gjeografike përcaktojnë objektin brenda të cilit duhet të vlerësohet fuqia e tregut e subjektit të ri që rrjedh nga përqendrimi. [12]

Pala ose palët njoftues duhet të paraqesin të dhënat e kërkuara duke patur parasysh përkufizimet e mëposhtme:

I. Tregjet përkatëse të produktit

Tregu përkatës i produktit përfshin të gjithë ata produkte dhe/ose shërbime që konsiderohen si të shkëmbyeshëm ose të zëvendësueshëm nga konsumatori, për shkak të karakteristikave të produkteve, çmimeve të tyre dhe përdorimit që duhet. Një treg përkatës i produktit në disa raste mund të përbëhet nga një numër produktesh individualë dhe/ose shërbimesh që paraqesin në një masë të madhe karakteristika fizike dhe teknike të njëjta dhe janë të shkëmbyeshëm.

Faktorët, në lidhje me vlerësimin e tregut përkatës të produktit, përfshijnë analizën se pse përfshihen produktet ose shërbimet në këto tregje dhe pse të tjerët përjashtohen duke përdorur përkufizimin e mësipërm dhe duke marrë parasysh, për shembull, zëvendësueshmërinë, kushtet e konkurrencës, çmimet, elasticitetin e çmimeve dhe faktorët të tjerë të rëndësishëm për përkufizimin e tregjeve të produkteve (për shembull, zëvendësueshmërinë e anës së furnizimit në rastet e përshtatshme).

II. Tregjet përkatës gjeografikë

Tregu përkatës gjeografik përbëhet nga zona në të cilën angazhohen ndërmarrjet e interesuara për furnizimin dhe kërkesën e produkteve ose shërbimeve përkatëse, në të cilin kushtet e konkurrencës janë homogjene në masë të mjaftueshme, dhe që mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje, veçanërisht, për shkak se kushtet e konkurrencës janë qartësisht të ndryshme në ato zona.

Faktorët që kanë të bëjnë me tregun përkatës gjeografik përfshijnë ndër të tjera natyrën dhe karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve përkatëse, ekzistencën e barrierave të hyrjes, preferencat e konsumatorëve, diferencat e dukshme në pjesët e tregut të ndërmarrjeve ndërmjet zonave gjeografike ose diferenca të mëdha në çmime.

III. Tregjet e raportueshme

Për qëllimet e informacionit të kërkuar në këtë formular, tregjet e prekura përbëhen nga tregjet përkatëse të produktit dhe gjeografikë, si dhe përkufizimet alternative të tregjeve përkatëse të mundshme të produkteve dhe gjeografike, mbi bazën e të cilëve:

(a) dy ose më shumë prej palëve në përqendrim janë angazhuar në aktivitete biznesi në tregun e të njëjtit nivel dhe ku përqendrimi do të drejtojë një pjesë të tregut të bashkuar prej 15% ose më shumë. Këto janë marrëdhënie horizontale;

(b) një ose më shumë prej palëve në përqendrim janë përfshirë në aktivitete biznesi në të njëjtin treg produkti, që është ngritja ose zbritja e një tregu produkti në të cilin është angazhuar një palë tjetër në përqendrim, dhe të gjitha pjesët e tyre të tregut individual apo të bashkuar tek çdo nivel është 25% ose më shumë pavarësisht nëse ka apo jo marrëdhënie ekzistuese furnitor/klient ndërmjet palëve në përqendrim. Këto janë marrëdhënie vertikale.

6.1. Mbi bazën e përkufizimeve të mësipërme identifikoni të gjithë tregjet e raportueshme.

SEKSIONI 7

Informacioni mbi tregjet

Për secilin treg të raportueshëm të përshkruar në Seksionin 6, për vitin paraprirës të veprimit, jepni sa më poshtë:
[13]

7.1. një vlerësim të madhësisë totale të tregut në kuptimin e vlerës së shitjeve (në Euro) dhe volum (njësi) [14]. Tregoni bazën dhe burimet për llogaritjet e jepni dokumente nëse ka për të vërtetuar këto llogaritje;

7.2. shitjet në vlerë dhe volum, si dhe një vlerësim të pjesëve të tregut për secilën nga palët në përqendrim. Tregoni nëse ka patur ndryshime të rëndësishme në shitje dhe pjesë të tregut në tre vitet e fundit financiare; dhe

7.3. për raportet horizontale dhe vertikale, një vlerësim të pjesës së tregut në vlerë (dhe sipas rastit, volum) të tre konkurrentëve më të mëdhenj (duke treguar bazën për vlerësimet). Jepni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të drejtorit të departamentit ligjor (ose një person tjetër që ushtron funksione të ngjashme; dhe në rastet kur nuk ka person të tillë, drejtorin ekzekutiv) për këta konkurrentë.

SEKSIONI 8

Efektet bashkëpunuese të një ndërmarrjeje të përbashkët

8. Për qëllimet e nenit 2 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

(a) A i mbajnë të dy ose më shumë shoqëri mëma aktivitetet në një masë të konsiderueshme në të njëjtin treg si ndërmarrje e përbashkët ose në një treg që është në ngritje ose zbritje nga ajo e ndërmarrjes së përbashkët apo në një treg fqinj të lidhur ngushtë me këtë treg? [15]

Nëse përgjigja është pohore, jeni të lutur të tregoni për secilin nga tregjet e përmendur këtu:

- xhiron e secilës shoqëri mëmë në vitin paraprirës financiar;
- rëndësinë ekonomike të aktiviteteve të ndërmarrjes së përbashkët në lidhje me këtë xhiro;
- pjesën në treg të secilit shoqëri mëmë.

Nëse përgjigja është negative, jeni të lutur të arsyetoni përgjigjen tuaj.

(b) Nëse përgjigja për (a) është pohore dhe sipas mendimit tuaj krijimi i ndërmarrjes së përbashkët nuk sjell bashkërendim ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura që të kufizojë konkurrencën në kuptimin e nenit 81 pika 1 të Traktatit të KE-së, jepni arsyet tuaja.

(c) Pavarësisht nga përgjigjet për (a) dhe (b) dhe me qëllim që të sigurohet bërja e një vlerësimi të plotë të çështjes nga Komisioni, jeni të lutur të shpjegoni si zbatohen kriteret e nenit 81 pika 3. Sipas nenit 81 pika 3, dispozitat e nenit 81 pika 1 mund të deklarohen të pazbatueshme nëse operacioni:

(i) kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjen e mallrave, ose në nxitjen e përparimit teknik dhe ekonomik;

(ii) u lejon konsumatorëve një pjesë të drejtë në përfitimin që del;

(iii) nuk vendos mbi ndërmarrjet përkatëse kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave; dhe

(iv) nuk u ofron këtyre ndërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës në lidhje me një pjesë thelbësore të produkteve në fjalë.

SEKSIONI 9

Deklarimi

Neni 2 pika 2 i Rregullores Zbatuese deklaron që, nëse njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin provë me shkrim që janë të autorizuar të veprojnë. Ky autorizim me shkrim duhet të shoqërojë njoftimin.

Njoftimi duhet të përfundojë me deklarin e mëposhtëm që duhet të nënshkruhet nga ose në emër të palëve njoftuese:

Pala ose palët njoftuese deklarojnë që, sipas njohurive dhe besimit të tyre të plotë, informacioni i dhënë në këtë njoftim është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe janë dhënë kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të kërkuara nga ky formular dhe të gjitha vlerësimet identifikohen si të tilla dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të mbështetura mbi faktet dhe të gjitha mendimet e shprehura janë të sinqerta.

Ato janë në dijeni të dispozitave të nenit 14 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

>PIC FILE= "L_2004133EN.003001.TIF">

(1) Rregullore e Këshillit (KE) nr. 139/2004 e 20 Janarit 2004, GZ L 24, 29.01.2004, fq. 1. Vëmendja juaj tërhiqet tek dispozitat përkatëse të Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Europiane (këtu të quajtur "Marrëveshja ZEE"). Shihni veçanërisht nenin 57 të Marrëveshjes ZEE, pika 1 e shtojcës XIV të Marrëveshjes ZEE dhe Protokollit 4 të Marrëveshjes ndërmjet shteteve të EFTA-s mbi ngritjen e një Autoriteti Mbikëqyrjeje dhe një Gjykate Drejtësie, si dhe Protokollin 21 dhe 24 të Marrëveshjes ZEE dhe nenin 1 të Shënimeve të Miratuara të Protokollit që përshtat Marrëveshjen ZEE. Çdo referencë në shtetet e EFTA-s kuptohet për ata shtete të EFTA-s që janë Palë Kontraktuese në Marrëveshjen e ZEE. Që nga 1 maji 2004, këto shtete janë Islanda, Lihtenshtaini dhe Norvegjia.

(2) Tregjet e produkteve janë tregje fqinje të lidhura ngushtë nëse produktet janë plotësuese të njëri-tjetrit ose kur ata i takojnë një game produktesh që përgjithësisht blihet nga e njëjta kategori klientësh për të njëjtin përdorim përfundimtar.

(3) Shih nenin 4 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

(4) Shih veçanërisht, nenin 122 të Marrëveshjes së ZEE-së, nenin 9 të Protokollit 24 të Marrëveshjes së ZEE-së dhe nenin 17 pika 2 të Kapitullit XIII të Protokollit 4 të Marrëveshjes ndërmjet shteteve të EFTA-s mbi ngritjen e një Autoriteti Mbikëqyrjeje dhe një Gjykate Drejtësie (Marrëveshja ESA).

(5) Shih seksionin 6.III për përkufizimin e tregjeve të raportueshme.

(6) Kjo përfshin shoqërimin e synuar në rastin e një oferte konkurruese, në të cilin rast hollësitë duhet të plotësohen në masën e mundur.

(7) Shih Shënimin e Komisionit mbi konceptin e ndërmarrjeve përkatëse.

(8) Shih, në përgjithësi, njoftimin e Komisionit mbi llogaritjen e xhiros. Xhiroja e palës përftuese ose e palëve në bashkim duhet të përfshijë xhiron e bashkuar të të gjitha ndërmarrjeve brenda kuptimit të nenit 5 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Xhiroja e palës ose palëve të përftuara duhet të përfshijë xhiron në lidhje me pjesët që i nënshtrohen transaksionit brenda kuptimit të nenit 5 pika 2 të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Dispozita të veçanta ndodhen në nenin 5 pikat 3, 4 dhe 5 të Rregullores së KE-së për Bashkimet për kredinë, sigurimet dhe institucione të tjera financiare dhe ndërmarrjet e përbashkëta.

(9) Shih nenin 57 të Marrëveshjes ZEE dhe veçanërisht nenin 2 pika 1 të Protokollit 24 të Marrëveshjes ZEE. Një rast kualifikohet si rast bashkëpunimi nëse xhirua e kombinuar e ndërmarrjeve të interesuara në territorin e shteteve të EFTA-s është i barabartë me 25% ose më shumë të xhiros së tyre të plotë brenda territorit që mbulohet nga Marrëveshja ZEE; ose secila prej të paktën dy ndërmarrjeve të interesuara ka një xhiro që i kalon 250 milion Euro në territorin e shteteve të EFTA-s; ose bashkimi mund të krijojë ose forcojë një pozicion dominues si rezultat i të cilit konkurrenca efektive do të pengohej në masë të konsiderueshme në territoret e shteteve të EFTA-s ose një pjesë të rëndësishme të tyre.

(10) Shih nenin 3 pikat 3, 4 dhe 5 dhe nenin 5 pika 4 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

(11) Shih Seksionin 6.III për përkufizimin e tregjeve të raportueshme.

(12) Shih Shënimin e Komisionit mbi përkufizimin e tregut përkatëse për qëllimet e së drejtës Komunitare për konkurrencën.

(13) Në kontekstin e parajnjoftimit, ju mund të diskutoni me Komisionin deri në cilën masë përjashtimi (heqja dorë) nga dhënia e informacionit të kërkuar do të ishte e përshtatshme për tregje të caktuara të raportueshëm.

(14) Vlera dhe volumi i tregut duhet të reflektojë prodhimin duke zbritur eksportet dhe shtuar importet për zonën gjeografike nën shqyrtim.

(15) Për përkufizimet e tregut referojuni Seksionit 6.

SHTOJCA III:

Formulari RS

(RS = deklaratë e arsyetuar në mbështetje të nenit 4 pikat 4 dhe 5 të Rregullores së Këshillit (EC) nr. 139/2004)

Formulari RS në lidhje me deklaratat e arsyetuara

Në mbështetje të neneve 4 pika 4 dhe 4 pika 5 të Rregullores (KE) nr. 139/2004

Hyrje

A. Qëllimi i këtij formulari

Ky formular përcakton informacionin që palët kërkuese duhet të paraqesin kur bëjnë një deklaratë të arsyetuar për një referencë para njoftimit sipas nenit 4 pikat 4 dhe (5) të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 (këtu të quajtur “Rregullorja e KE-së për Bashkimet”).

Vëmendja tuaj tërhiqet tek Rregullorja e KE-së për Bashkimet dhe tek Rregullorja e Komisionit (KE) nr. (.../2004) (këtu quhet Rregullorja Zbatuese e KE-së për Bashkimet”). Teksti i këtyre rregulloreve, si dhe dokumente të tjerë të rëndësishëm, mund të gjenden në faqen e Konkurrencës në adresën e internetit “Europa” të Komisionit.

Eksperiencia ka treguar që kontaktet paraprake janë tepër të vlefshme për të dy palët dhe autoritetet përkatëse në caktimin e masës dhe tipit të saktë të informacionit të kërkuar. Për pasojë, palët inkurajohen të këshillohen me Komisionin dhe Shtetin(et) Anëtare përkatës në lidhje me përshtatshmërinë e objektit dhe tipit të informacionit mbi të cilin ato synojnë të bazojnë deklaratat e tyre të arsyetuara.

B. Kërkesa që një deklaratë e arsyetuar të jetë e saktë dhe e plotë

I gjithë informacioni i kërkuar nga ky formular duhet të jetë i saktë dhe i plotë. Informacioni i kërkuar duhet të jepet në seksionin e përshtatshëm në këtij formulari.

Informacioni i pasaktë ose i gabuar në deklaratën e arsyetuar do të konsiderohet të jetë informacion i paplotë (neni 5 pika 4 e Rregullores Zbatuese të KE-së për Bashkimet).

Nëse palët paraqesin informacion të pasaktë, Komisioni do të ketë kompetencën të shfuqizojë çdo vendim sipas nenit 6 dhe 8 që ai miraton pas një referimi në nenin 4 pika 5, në përputhje me nenin 6 pika 3 gërma a ose neni 8 pika 6 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet. Pas shfuqizimit, ligjet e brendshme të konkurrencës do të ishin përsëri të zbatueshëm tek transaksioni. Në rastin e referimeve sipas nenit 4 pika 4 të bërë në bazë të informacionit të pasaktë, Komisioni mund të kërkojë që njoftim në mbështetje të me nenin 4 pika 1. Përveç kësaj, Komisioni do të ketë kompetencën të vendosë gjoba për paraqitjen e informacionit të pasaktë ose të gabuar në përputhje me nenin 14 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet. (Shih pikën d më poshtë). Së fundi, palët duhet të jenë të ndërgjegjshme që nëse një referim bëhet mbi bazën e informacionit të pasaktë, të gabuar ose të paplotë të përfshirë në Formularin RS, Komisioni dhe/ose Shtetet Anëtare mund të konsiderojnë të bëjnë një referim pas njoftimit që korrigjon referimin e bërë para njoftimit.

Veçanërisht ju duhet të vini re që:

(a) Në përputhje me nenin 4 pikat 4 dhe 5 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, Komisioni është i detyruar t’ua transmetojë deklaratat e arsyetuara Shteteve Anëtare pa vonesë. Afatet kohore për shqyrtimin e deklaratave të arsyetuara do të fillojë me marrjen e deklaratës nga Shteti ose Shtetet përkatëse Anëtare. Vendimi për aderimin ose jo në një deklaratë të arsyetuar do të merret normalisht mbi bazën e informacionit që ndodhet atje, pa bërë përpjekje të mëtejshme për hetime nga autoritetet e angazhuara.

(b) Palët që bëjnë deklaratën duhet para së gjithash të verifikojnë, në kuadrin e përgatitjes së deklaratës së tyre të arsyetuar, që i gjithë informacioni dhe argumentet që merren për bazë të jenë të mbështetura si duhet mbi burime të pavarura.

(c) Sipas nenit 14 paragrafi 1 pika a të Rregullores së KE-së për Bashkimet, palët që bëjnë një deklaratë të arsyetuar që, me qëllim ose nga pakujdesia, japin informacion të pasaktë ose të gabuar, mund të marrin gjoba deri në 1% të xhiros së plotë të ndërmarrjes përkatëse.

(d) Ju mund të kërkoni me shkrim që Komisioni të pranojë që deklarata e arsyetuar është e plotë megjithë mosdhënien e informacionit të kërkuara nga ky formular, nëse ky informacion nuk mund të merret normalisht prej jush pjesërisht ose plotësisht (për shembull, për shkak të mospasjes së informacionit për shoqërinë e synuar gjatë ofertës konkurruese).

Komisioni do ta shqyrtojë këtë kërkesë, me kusht që ju të jepni arsyet për mosdhënien e informacionit, dhe të jepni vlerësimet tuaja më të mira për të dhënat që mungojnë së bashku me burimet për vlerësimet. Nëse është e mundur, duhet të jepen edhe tregues se ku mund të merret nga Komisioni ose Shteti(et) Anëtare përkatës informacioni i kërkuar që nuk është dhënë.

(e) Ju mund të kërkoni që Komisioni të pranojë që deklarata e arsyetuar është e plotë megjithë mosdhënien e informacionit të kërkuar nga ky formular, nëse ju mendoni që një informacion i caktuar i kërkuar nga ky formular mund të mos jetë i nevojshëm për shqyrtimin nga Komisioni ose Shteti(et) Anëtare përkatëse të çështjes.

Komisioni e shqyrton këtë kërkesë, me kusht që ju të jepni shkaqe të përshtatshme pse ky informacion nuk është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për trajtimin e kërkesës tuaj për një referim para njoftimit. Ju duhet ta shpjegoni këtë gjatë kontakteve tuaja paraprake me Komisionin dhe me Shtetin(et) Anëtarë përkatës dhe të paraqisni një kërkesë me shkrim për heqje dorë nga përgjegjësia duke i kërkuar Komisionit t'u përjashtojë nga detyrimi për të dhënë këtë informacion, në përputhje me nenin 4 pika 2 të Rregullores Zbatuese të KE-së për Bashkimet. Komisioni mund të këshillohet me autoritetin ose autoritetet përkatës të Shtetit Anëtar para vendimit për miratimin e një kërkesë të tillë.

C. Personat që kanë të drejtë të paraqesin deklarata të arsyetuara

Në rastin e një bashkimi sipas kuptimit të nenit 3 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet ose përfutimit të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrjeje brenda kuptimit të nenit 3 pika 1 gërma b të Rregullores për Bashkimet, deklarata e arsyetuar duhet të bëhet së bashku nga palët në bashkim ose prej atyre që përftojnë kontroll të përbashkët, sipas rastit.

Në rastin e përfutimit të një zotërim kontrolli në ndërmarrje nga një tjetër, përfutuesi duhet të bëjë deklaratën e arsyetuar.

Në rastin e një oferte publike për të përfutuar një ndërmarrje, ofertuesi duhet të bëjë deklaratën e arsyetuar.

Secila palë që bën një deklaratë të arsyetuar është përgjegjës për saktësinë e informacionit që ajo jep.

D. Si bëhet deklarata e arsyetuar

Deklarata e arsyetuar duhet të bëhet në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian. Kjo gjuhë pas kësaj do të jetë gjuha e procedimit për të gjitha palët deklaruese.

Me qëllim që të lehtësohet trajtimi i Formularit RS nga autoritetet e Shteteve Anëtare, palët inkurajohen së tepërmi t'i paraqesin Komisionit në përkthim të deklaratës së tyre të arsyetuar në gjuhën ose gjuhët që kuptohet nga të gjithë ata që u drejtohet informacioni. Në lidhje me kërkesat për një referim në një ose disa Shtete Anëtare, palët

kërkuese inkurajohen së tepërmi të përfshijnë një kopje të kërkesës në gjuhën(t) e Shtetit(eve) Anëtar(e) për të cilin kërkohet referimi.

Informacioni i kërkuar nga ky formular duhet të jepet duke përdorur seksionet dhe numrat e paragrafëve të formularit, duke nënshkruar në fund deklaratën, dhe duke bashkangjitur dokumentacionin mbështetës. Për hir të qartësisë, një pjesë e informacionit mund të futet në anekse. Megjithatë, është thelbësore që pjesët kryesore të informacionit të përfshihen në strukturën e Formularit RS. Anekset në këtë formular do të përdoren të plotësojnë informacionin e dhënë nga vetë formulari.

Dokumentet shoqëruese do të paraqiten në gjuhën e tyre origjinale; nëse kjo nuk është një gjuhë zyrtare e Komunitetit, ato duhet të përkthehen në gjuhën e procedimit.

Dokumentet shoqëruese mund të jenë në origjinal ose kopje të origjinaleve. Në rastin e fundit, pala njoftuese duhet të vërtetojë që ato janë të vërteta dhe të plota.

Një origjinal dhe 35 kopje të Formularit RS dhe të dokumenteve shoqëruese duhet t'i paraqiten Komisionit. Deklarata e arsyetuar do të dorëzohet në adresën e përmendur në nenin 23 pika 1 të Rregullores Zbatuese të KE-së për Bashkimet dhe në formatin e përcaktuar nga shërbimet e Komisionit.

Deklarata paraqitet në adresën e Drejtorisë së Përgjithshme për Konkurrencën (PD Konkurrencës) të Komisionit. Kjo adresë botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Deklarata duhet t'i jepet Komisionit në ditët e punës sipas përcaktimit në nenin 24 të Rregullores Zbatuese të KE-së për Bashkimet. Me qëllim që të mundësohet prej tij regjistrimi në të njëjtën ditë, ajo duhet të paraqitet para orës 17.00 nga e hëna deri të enjten, dhe para orës 16.00 të premtëve dhe ditëve të punës para ditëve të festave dhe ditëve të festave të tjera që përcaktohen nga Komisioni dhe botohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian. Udhëzimet për sigurinë të dhëna në faqet elektronike të DP të Konkurrencës duhet të respektohen.

E. Konfidencialiteti

Neni 287 i Traktatit dhe neni 17 pika 2 i Rregullores së KE-së për Bashkimet kërkojnë që Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, nëpunësit e tyre dhe punonjës të tjerë, dhe personat e tjerë që punojnë nën mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve si dhe nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të shërbimit civil të autoriteteve të tjera të Shteteve Anëtare të mos e deklarojnë informacionin që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional që ata kanë përftuar nëpërmjet zbatimit të rregullores. I njëjti parim duhet të zbatohet edhe për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet palëve deklaruese.

Nëse ju besoni që interesat tuaja do të dëmtohen nëse një nga informacionet që u kërkohet do të botohej ose do t'u bëhej i ditur palëve të tjera, këtë informacion paraqiteni veçmas, ku në secilën faqe të jetë shënuar qartë "Sekrete biznesi". Ju duhet të jepni edhe arsyet pse ky informacion nuk duhet të deklarohet ose botohet.

Në rastin e bashkimeve ose përfitimeve të përbashkëta, ose në raste të tjera ku njoftimi bëhet nga më shumë se njëra prej palëve, sekretet e biznesit mund të paraqiten nën anekse të veçanta dhe të bëhet referencë në deklaratë si aneks. Të gjitha këto anekse duhet të përfshihen në deklaratë e arsyetuar.

F. Përkufizime dhe udhëzime për qëllimet e këtij formulari

Pala ose palët deklaruese: në rastet ku një deklaratë e arsyetuar paraqitet nga vetëm një prej ndërmarrjeve që është palë në një veprim, "palët deklaruese" përdoret si referencë tek vetëm njëra ndërmarrje që faktikisht paraqet deklaratën.

Pala(ët) në përqendrim ose palët: këto terma kanë të bëjnë me palët përfutuese dhe palët e përfutura, ose me palët që bashkohen, duke përfshirë të gjitha ndërmarrjet në të cilat përftohet një zotërim kontrolli ose që i nënshtrohet një oferte publike.

Nëse nuk është përcaktuar ndryshe, “termat pala(ët) deklaruese” dhe “pala(ët) në përqendrim” përfshijnë të gjitha ndërmarrjet që u takojnë të njëjtëve grupe si dhe ato “palë”.

Tregjet e prekur: Seksioni 4 i këtij formulari kërkon që palët deklaruese të identifikojnë tregjet e produkteve përkatëse dhe më tej të identifikojnë se cili nga këta tregje përkatës mund të preken nga veprimi i njoftuar. Ky përcaktim i tregjeve të prekur përdoret si bazë për marrjen e informacionit për një numër çështjesh të tjera që gjenden në këtë formular. Përcaktimet e dhëna nga palët deklaruese referohen në këtë formular si treg(je) të prekura. Ky term i referohet një tregu përkatës që përbëhet nga produkte ose shërbime.

Viti: të gjitha referencat në fjalën “vit” në këtë formular duhet të kuptohen si kuptimi i vitit kalendarik, përveç kur deklarohet ndryshe. I gjithë informacioni i kërkuar në këtë formular, nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet të lidhet me vitin para tij të deklaratës.

Të dhënat financiare të kërkuara në këtë formular duhet të jepen në Euro me kurset mesatare të këmbimit që mbizotërojnë për vitet ose periudhat e tjera në fjalë.

Të gjitha referencat që gjenden në këtë formular janë për nenet dhe paragrafët e Rregullores së KE-së për Bashkimet, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

SEKSIONI 1

Informacion paraprak

1.0 Tregoni nëse deklarata e arsyetuar është bërë sipas nenit 4 pikat 4 ose 5.

- referim në nenin 4 pika 4
- referim në nenin 4 pika 5

1.1. Informacioni për palën(t) deklaruese

Jepni hollësi për:

1.1.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

1.1.2. natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

1.1.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike, dhe pozicionin që mbahet nga personi përshtatshëm i kontaktit; dhe

1.1.4. adresën postare të shërbimit të palës deklaruese (secilës prej palëve deklaruese) ku mund të dorëzohen dokumentet dhe veçanërisht, vendimet e Komisionit. Duhet të jepet emri, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike e personit në këtë adresë që është i autorizuar të pranojë postën.

1.2. Informacioni mbi palët e tjera në përqendrim.

Për secilën palë në përqendrim (përveç palës ose palëve deklaruese) jepni hollësi për:

1.2.1. emrin dhe adresën e ndërmarrjes;

1.2.2. natyrën e biznesit të ndërmarrjes;

1.2.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike, dhe pozicionin që mbahet nga personi përshtatshëm i kontaktit; dhe

1.2.4. adresën postare të shërbimit të palës (secilës prej palëve) ku mund të dorëzohen dokumentet dhe, veçanërisht, vendimet e Komisionit. Duhet të jepet emri, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike e personit në këtë adresë që është i autorizuar të pranojë postën.

1.3. Emërimi i përfaqësuesve

Nëse deklaratat e arsyetuara nënkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin prova shkresore që ata janë të autorizuar për të vepruar. Prova me shkrim duhet të përmbajë emrin dhe pozicionin e personave që japin këtë autorizim.

Jepni të dhënat e mëposhtme të kontaktit për çdo përfaqësues që është autorizuar të veprojë për një prej palëve në përqendrim, duke treguar kë ata përfaqësojnë:

1.3.1. emrin e përfaqësuesit

1.3.2. adresën e përfaqësuesit

1.3.3. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e postës elektronike të personit që duhet të kontaktohet dhe

1.3.4. një adresë të përfaqësuesit (në Bruksel nëse ka) ku mund të dërgohet korrespondenca dhe të dorëzohen dokumentet.

SEKSIONI 2

Të dhëna të përgjithshme paraprake dhe hollësi të përqendrimit

2.1. Përshkruani të dhënat e përgjithshme të përqendrimit. Veçanërisht, jepni një vështrim të përgjithshëm të arsyeve kryesore të transaksionit, duke përfshirë argumentimin e tij ekonomik dhe strategjik.

Jepni një përmbledhje të shkurtër të përqendrimit, duke caktuar palët në përqendrim, natyrën e përqendrimit (për shembull, bashkim, përfitim ose ndërmarrje e përbashkët), zonat e aktivitetit të palëve deklaruese, tregjet në të cilat përqendrimi do të ketë ndikim (duke përfshirë tregjet kryesore të prekur[2]), dhe argumentimin e strategjik dhe ekonomik të përqendrimit.

2.2. Përshkruani natyrën ligjore të transaksionit që i nënshtrohet deklaratës së arsyetuar. Për ta bërë këtë, tregoni:

(a) nëse përqendrimi i nënshtrohet tërësia ose pjesë të palëve;

(b) data e propozuar ose e pritshme e ngjarjeve kryesore të planifikuara për të realizuar përfundimin e përqendrimit;

(c) struktura e propozuar e pronësisë dhe kontrolli pas përfundimit të përqendrimit; dhe

(d) nëse transaksioni i propozuar është një përqendrim brenda kuptimit të nenit 3 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

2.3. Renditni sektorët ekonomikë të përfshirë në përqendrim.

2.3.1. Deklaroni vlerën e transaksionit (çmimin e blerjes ose vlerën e të gjithë sendeve pasurore të përfshirë, sipas rastit).

2.4. Jepni të dhëna të mjaftueshme financiare ose të tjera për të treguar që përqendrimi arrin ose nuk arrin pragjet juridiksionale sipas nenit 1 të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

2.4.1. Jepni një pasqyrë të hollësishme të xhiros Komunitare të arritur nga ndërmarrjet përkatëse, duke treguar, sipas rastit, Shtetet Anëtare, nëse ka, ku bëhet më shumë se dy të tretat e xhiros.

SEKSIONI 3

Pronësia dhe kontrolli [3]

Për secilën nga palët në përqendrim jepni një listë të të gjitha ndërmarrjeve që i takojnë të njëjtit grup. Kjo listë duhet të përfshijë:

3.1. të gjitha ndërmarrjet ose personat që kontrollojnë këto palë drejtpërdrejt ose jo;

3.2. të gjitha ndërmarrjet që veprojnë në një treg të prekur [4] që kontrollohen drejtpërdrejt ose jo:

- (a) nga këto palë;
- (b) nga një ndërmarrje tjetër të identifikuar në 3.1.

Për çdo hyrje të renditur më sipër, duhet të përcaktohet natyra dhe mjete i kontrollit.

Informacioni i kërkuar në këtë seksion mund të ilustron me përdorimin e organigramave ose diagrameve për të treguar strukturën e pronësisë dhe kontrollin e ndërmarrjeve.

SEKSIONI 4

Përkufizimet e tregut

Produkti përkatës dhe tregjet gjeografike përcaktojnë objektin brenda të cilit duhet të vlerësohet fuqia e tregut e subjektit të ri që rrjedh nga përqendrimi. [5]

Pala ose palët deklaruese duhet të japin të dhënat që kërkohen duke patur parasysh përkufizimet e mëposhtme:

I. Tregjet përkatës të produkteve:

Tregu përkatës i produktit përfshin të gjithë ata produkte dhe/ose shërbime që konsiderohen si të shkëmbyeshëm ose të zëvendësueshëm nga konsumatori, për shkak të karakteristikave të produkteve, çmimeve të tyre dhe përdorimit që duhet. Një treg përkatës i produktit në disa raste mund të përbëhet nga një numër produktesh individualë dhe/ose shërbimesh që paraqesin në një masë të madhe karakteristika fizike dhe teknike të njëjta dhe janë të shkëmbyeshëm.

Faktorët në lidhje me vlerësimin e tregut përkatës të produktit përfshin analizën se pse përfshihen produktet ose shërbimet në këto tregje dhe pse të tjerët përjashtohen duke përdorur përkufizimin e mësipërm dhe duke marrë parasysh, për shembull, zëvendësueshmërinë, kushtet e konkurrencës, çmimet, elasticitetin e çmimeve dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për përkufizimin e tregjeve të produkteve (për shembull, zëvendësueshmërinë e anës së furnizimit në rastet e përshtatshme).

II. Tregjet përkatës gjeografikë

Tregu përkatës gjeografik përbëhet nga zona në të cilën angazhohen ndërmarrjet e interesuara për furnizimin dhe kërkesën e produkteve ose shërbimeve përkatëse, në të cilin kushtet e konkurrencës janë homogjene në masë të mjaftueshme dhe që mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje veçanërisht për shkak se kushtet e konkurrencës janë qartësisht të ndryshme në ato zona.

Faktorët që kanë të bëjnë me vlerësimin e tregut përkatës gjeografik përfshijnë ndër të tjera natyrën dhe karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve përkatëse, ekzistencën e barrierave të hyrjes, preferencat e konsumatorëve, diferencat e dukshme në pjesët e tregut të ndërmarrjeve ndërmjet zonave gjeografike ose diferenca të mëdha në çmime.

III. Tregjet e prekura

Për qëllimet e informacionit të kërkuar në këtë formular, tregjet e prekura përbëhen nga tregjet përkatëse të produktit, ku në Komunitet ose në një Shtet Anëtar:

(a) dy ose më shumë prej palëve në përqendrim janë angazhuar në aktivitete biznesi në tregun e të njëjtit produkt dhe ku përqendrimi do të çojë në një pjesë të kombinuar të tregut prej 15% ose më shumë. Këto janë marrëdhënie raporte horizontale;

(b) një ose më shumë prej palëve në përqendrim janë përfshirë në aktivitete biznesi në një treg produktesh, që është ngritja ose zbritja e një tregu produkti në të cilin është angazhuar një palë tjetër në përqendrim, dhe një nga pjesët individuale ose të kombinuara të tregut në çdo nivel është 25% ose më shumë, pavarësisht nëse ka apo jo raporte ekzistuese furnitor/klient ndërmjet palëve në përqendrim [6]. Këto janë marrëdhënie vertikale.

Mbi bazën e përkufizimeve të mësipërme dhe pragjeve të pjesëve të tregut, jepni informacionin e mëposhtëm:

4.1. Identifikoni secilin treg të prekur brenda kuptimit të Seksionit III:

(a) në nivel Komunitar;

(b) në rastin e një kërkesë për referim në përputhje me nenin 4 pika 4, në nivelin e secilit Shtet Anëtar individual;

(c) Në rastin e një kërkesë për referim sipas nenit 4 pika 5, në nivelin e secilit Shtet Anëtar të identifikuar në Seksionin 6.3.1. të këtij formulari në gjendje për rishikimin e përqendrimit.

4.2. Përveç kësaj, shpjegoni mendimet e palëve deklaruese në lidhje me objektin e tregut gjeografik përkatës brenda kuptimit të Seksionit II që zbatohet në lidhje me çdo treg që preket të identifikuar më sipër.

SEKSIONI 5

Informacioni mbi tregjet e prekur

Për secilin nga tregjet përkatëse të prekura të produktit, për vitin e fundit financiar:

(a) për Komunitetin si një i tërë;

(b) në rastin e një kërkesë për referim në përputhje me nenin 4 pika 4, individualisht për secilin Shtet Anëtar ku palët në përqendrim bëjnë biznes, dhe

(c) në rastin e një kërkesë për referim sipas nenit 4 pika 5, individualisht për secilin Shtet Anëtar të identifikuar në Seksionin 6.3.1 të këtij formulari në gjendje për të rishikuar përqendrimin ku palët në përqendrim bëjnë biznes; dhe

(d) nëse sipas mendimit të palëve njoftuese, tregu përkatës gjeografik është i ndryshëm;
paraqisni sa më poshtë:

5.1. një vlerësim të madhësisë së përgjithshme të tregut në kuptimin e vlerave të shitjeve (në Euro) dhe volum (njësi) [7]. Tregoni bazën dhe burimet për llogaritjet dhe paraqisni dokumente sipas rastit për të vërtetuar këtë llogaritje;

5.2. shitjet në vlerë dhe volum, si dhe një vlerësim të pjesëve të tregut, për secilën nga palët në përqendrim;

5.3. një vlerësim të pjesës së tregut në vlerë (dhe, sipas rastit, volum) të të gjithë konkurrentëve (duke përfshirë importuesit) duke marrë parasysh të paktën 5% të tregut gjeografik.

Mbi këtë bazë, jepni një vlerësim të indeksit HHI [8] para dhe pas bashkimit, dhe diferencën ndërmjet të dyve (delta) [9]. Tregoni raportin e pjesëve të tregut që përdoren si bazë për të llogaritur HHI-në. Identifikoni burimet e përdorura për të llogaritur këto tregje dhe jepni dokumente sipas rastit për të vërtetuar llogaritjen;

5.4. pesë klientët më të mëdhenj të pavarur të palëve në secilin treg të prekur, dhe pjesën e tyre individuale të shitjeve të plota për këto produkte që mbulohe nga secili prej këtyre klientëve;

5.5. natyrën dhe masën e integritit vertikal të secilës prej këtyre palëve në përqendrim krahasuar me konkurrentët e tyre më të mëdhenj;

5.6. identifikoni pesë furnitorët më të mëdhenj [10] të pavarur të palëve;

5.7. gjatë pesë viteve të fundit, a ka patur ndonjë hyrje të rëndësishme në një treg të prekur? Sipas mendimit të palëve deklaruese, a ka ndërmarrje (duke përfshirë ato që tashmë operojnë në tregje ekstrakomunitare) që mund të hyjnë në treg? Jeni të lutur të saktësoni.

5.8. në ç' masë ekzistojnë marrëveshjet bashkëpunuese (horizontale ose vertikale) në tregjet e prekura?

5.9. nëse përqendrimi është ndërmarrje e përbashkët, a i mbajnë dy ose më shumë shoqëri mëma aktivitetet në një masë të konsiderueshme në të njëjtin treg si ndërmarrja e përbashkët, ose në një treg që është në zbritje ose në ngritje nga ai i ndërmarrjes së përbashkët në një treg fqinj të lidhur ngushtë me këtë treg? [11]

5.10 përshkruani ndikimin e mundshëm të përqendrimit të propozuar mbi konkurrencën në tregjet e prekura, dhe si përqendrimi i propozuar mund të ndikojë interesat e klientëve të ndërmjetëm dhe fundorë dhe zhvillimin e përparimit teknik dhe ekonomik.

SEKSIONI 6

Hollësi për kërkesën e referimit dhe shkaqet pse çështja duhet të referohet

6.1. Tregoni nëse deklarata e arsyetuar është bërë në përputhje me nenin 4 pikat 4 ose 5 të Rregullores së KE-së për Bashkimet, dhe plotësoni vetëm nënseksionin përkatës:

- referimi i nenit 4.4.

- referimi i nenit 4.5.

Nënseksioni 6.2

Referimi i nenit 4 pika 4

6.2.1. Identifiko Shtetin Anëtar ose Shtetet Anëtare që, në përputhje me nenin 4 pika 4, ju u parashtroni duhet të shqyrtojnë përqendrimin, duke treguar nëse ju keni marrë ose jo kontakt jozyrtar me këtë Shtet(e) Anëtar.

6.2.2. Saktësoni nëse kërkonte referimin e të gjithë apo një pjese të çështjes.

Nëse kërkonte referimin e një pjese të çështjes, saktësoni qartë pjesën ose pjesët e çështjes për të cilat ju kërkonte referim.

Nëse kërkonte referimin e të gjithë çështjes, duhet të vërtetoni që nuk ka tregje të prekura jashtë territorit të Shtetit(e) Anëtare për të cilët ju bëni kërkesën për referim.

6.2.3. Shpjegoni në cilën mënyrë secili prej tregjeve të prekura në Shtetin ose Shtetet Anëtare për të cilët është bërë kërkesa për referim paraqet të gjitha karakteristikat e një tregu të qartë brenda kuptimit të nenit 4 pika 4.

6.2.4. Shpjegoni në cilën mënyrë mund të ndikohet në masë të konsiderueshme konkurrenca në secilin prej tregjeve të dalluar të përmendur më sipër në kuptimin e nenit 4 pika 4.

6.2.5. Në rast se një Shtet(e) Anëtar merr kompetencë për të rishikuar tërësisht ose pjesërisht çështjen pas një referimi në përputhje me nenin 4 pika 4, a pranoni që informacioni që gjendet në këtë formular të merret për bazë nga Shteti(et) Anëtar në fjalë për qëllimin e procedimit të tij(tyre) të brendshëm në lidhje me atë çështje ose pjesë të saj? Po ose Jo.

Nënseksioni 6.3

Referimi i nenit 4 pika 5

6.3.1. Për secilin Shtet Anëtar, saktëso nëse përqendrimi është ose jo i mundur të rishikohet në bazë të ligjit të tij të brendshëm për konkurrencën. Duhet të shënoni një kuti për secilin dhe çdo Shtet Anëtar.

A mund të rishikohet përqendrimi në bazë të ligjit të brendshëm për konkurrencën të secilit prej Shteteve Anëtare të mëposhtme? Ju duhet të përgjigjeni për secilin Shtet Anëtar. Trego vetëm Po ose Jo për secilin Shtet Anëtar. Mosshënimi me Po ose Jo për një Shtet Anëtar do të konsiderohet sikur është një shënim Po për atë Shtet Anëtar.

>PIC FILE= "L_2004133EN.003801.TIF">

6.3.2. Për secilin Shtet Anëtar, jepni të dhëna të plota financiare dhe të tjera për të treguar që përqendrimi përmbush ose jo kriteret përkatëse juridiksionale në bazë të ligjit të zbatueshëm të brendshëm për konkurrencën.

6.3.4. Shpjegoni pse çështja duhet të shqyrtohet nga Komisioni. Shpjegoni, veçanërisht, nëse përqendrimi mund të ndikojë konkurrencën jashtë territorit të një Shteti Anëtar.

SEKSIONI 7

Deklarimi

Rrjedh nga nenet 2 pika 2 dhe 6 pika 2 të Rregullores Zbatuese të KE-së për Bashkimet që nëse deklaratat e arsyetuara nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin provë me shkrim që janë të autorizuar të veprojnë. Ky autorizim me shkrim duhet të shoqërojë deklaratën.

Njoftimi duhet të përfundojë me deklarin e mëposhtëm që duhet të nënshkruhet nga ose në emër të palëve njoftuese:

Pala ose palët deklaruese deklarojnë që, pas verifikimeve të kujdesshme, sipas njohurive dhe besimit të tyre të plotë, informacioni i dhënë në këtë deklaratë të arsyetuar është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe janë dhënë kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të kërkuara nga Formulari RS, dhe të gjitha vlerësimet identifikohen si të tilla dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të mbështetura mbi faktet dhe të gjitha mendimet e shprehura janë të sinqerta.

Ato janë në dijeni të dispozitave të nenit 14 pika 1 gërma a të Rregullores së KE-së për Bashkimet.

>PIC FILE= "L_2004133EN.003901.TIF">

(1) Kjo përfshin shoqërinë e synuar në rastin e ofertës konkurruese, rast në të cilin hollësitë duhet të plotësohen në masën që është e mundur.

(2) Shih Seksionin 4 për përkufizimin e tregjeve të prekura.

(3) Shih nenin 3 pikat 3, 4 dhe 5 dhe nenin 5 pika 4.

(4) Shih Seksionin 4 për përkufizimin e tregjeve të prekur.(5) Shih Shënimin e Komisionit mbi përkufizimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit Komunitar për konkurrencën.

(6) Për shembull, nëse një palë në përqendrim ka një pjesë tregu më të madhe se 25% në një treg që është në ngritje të një tregu në të cilin pala tjetër është aktive, atëherë të dy tregjet në ngritje dhe në zbritje janë tregje të prekur. Po kështu, nëse një shoqëri e integruar vertikalisht bashkohet me një palë tjetër që është aktive në nivelin e zbritjes, dhe bashkimi realizon një pjesë tregu të kombinuar në zbritje prej 25% ose me shumë, atëherë të dy tregjet në ngritje dhe zbritje janë tregje të prekur.

(7) Vlera dhe volumi i një tregu duhet të reflektojnë prodhimin duke i zbritur eksportet dhe shtuar importet për zonat gjeografike që shqyrtohen.

(8) HHI do të thotë Indeksi Herfindahl-Hirschman, një masë e përqendrimit të tregut. HHI llogaritet duke mbledhur katrorët e pjesëve individuale të tregut të të gjitha firmave në treg. Për shembull, një treg që ka pesë firma me pjesë në treg prej përkatësisht 40 %, 20 %, 15 %, 15 %, dhe 10 %, ka një HHI prej 2550 (40² + 20² + 15² + 15² + 10² = 2550). HHI ndryshon nga gati zero (në një treg të ndarë) në 10000 (në rastin e monopolit të pastër). HHI pas bashkimit llogaritet mbi supozimin e punës që pjesët individuale në treg të shoqërive ndryshojnë. Megjithatë është më mirë të përfshihen të gjitha firmat në llogaritje, mungesa e informacionit në lidhje me firmat shumë të vogla mund të mos jetë i rëndësishëm pasi këto firma nuk ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mbi HHI.

(9) Rritja e përqendrimit sipas matjes nëpërmjet HHI-së mund të llogaritet në mënyrë të pavarur për të gjithë përqendrimin e tregut duke dyfishuar produktin e pjesëve të tregut të firmave që bashkohen. Për shembull, një bashkim i dy firmave me pjesë në treg prej 30% dhe 15% përkatësisht do të rrisnin HHI-së me 900 (30 x 15 x 2 = 900). Shpjegimi për këtë teknikë është si më poshtë: Para bashkimit, pjesët e

tregut të firmave që bashkohen kontribuojnë në HHI nëpërmjet katrorëve të tyre individualisht: $(a)^2 + (b)^2$. Pas bashkimit, kontributi është katrori i shumave të tyre: $(a + b)^2$, që është e barabartë me $(a)^2 + (b)^2 + 2ab$. Rritja në HHI përfaqësohet me $2ab$.

(10) D.m.th, furnitorët që nuk janë filiale, agjentë ose ndërmarrje që janë pjesë e grupit të palës në fjalë. Përveç atyre pesë furnitorëve të pavarur, palët njoftuese, nëse ato e mendojnë të nevojshme për një vlerësim të saktë të çështjes, identifikojnë furnitorët e brendshëm. E njëjta zbatohet në lidhje me konsumatorët.

(11) Për përkufizimet e tregut referojuni Seksionit 4.